13 PË. Ka qenë i ndaluar edhe me një kushëri timin i cili është
14 akuzuar për një vjedhje atëherë, e cila ka qenë pa bazë akuza,
15 dhe pas dy ditëve e kanë liru.

16 PY. Si quhet ky personi tjetër?

17 PË. Avdullah Shabanaj.

18 PY. Na trego pak historinë tjetër, pjesën tjetër të
19 historisë, Dëshmitar? Si u largua nga ndalimi Fetah Rudi?

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 dëshmitari tha që e ka dëgjuar që është mbajtur i ndaluar
22 Fetah Rudi. Do ishte mirë që të pyetej një herë dëshmitari nga
23 kush e ka dëgjuar.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Neve e thamë se cila ishte baza e
25 kësaj pyetjeje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 vazhdoni më tej.

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, dëshironi që t'jua përsëris edhe një herë
5 pyetjen, apo e dëgjuat? Si arriti që të lirohej nga ai vendi
6 ku ndalohej Fetah Rudi, si është pjesa tjetër e historisë,
7 Dëshmitar?

8 PË. Simbas Fetahit, e kanë çu dikund siç thotë ai një gjyq
9 ushtarak, dhe atje i kanë thanë je i lirë, dhe është liruar.

10 PY. Dua të pyes edhe për një person tjetër që quhet Ramiz
11 Hoxha, të cilin ju e diskutoni në intervistën që i keni dhënë
12 ZPS-së.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, është prova M-
14 1694.3 [Sipas përkthimit].

15 PY. Ju thoni që ky person është akuzuar si kolaboracionist
16 serb dhe që është vrarë edhe pse ai nuk ka qenë
17 kolaboracionist. Dua t'ju kërkoj që të tregoni historinë, së
18 pari, pse është akuzuar Ramiz Hoxha që ka qenë
19 kolaboracionist, Dëshmitar?

20 PË. Prokuror, edhe atëherë edhe sot m'u kanë bë këto pyetje
21 të cilat unë nuk kam qenë në atë kohë aty, por mund t'i
22 shtjelloj për arsye të lidhjeve të mia të afërme familjare me
23 familjen e Ramiz Hoxhës.

24 PY. Faleminderit. Ju lutem, na e shpjegoni më tej.

25 PË. Pas një kërkesë të fshatarëve të fshatit Bellanicë që të

1 dalin dhe t'i mbledhin të korrat e vjeshtës në atë kohë,
2 misrin dhe pasulin, por nuk ishin të lirë të vendosnin të
3 kryenin këtë aktivitet për arsye se policia dhe ushtria serbe
4 ishin shumë afër fshatit dhe andej nga ishin arat me të
5 mbjella. Ata marrin vendim që të shkojnë të bisedojnë dhe t'i
6 njoftojnë ushtrinë serbe që na t'i kryejmë punët e vjeshtës në
7 arat e tyre.

8 Pasi kanë ngja këto bisedime, dhe kanë fillu të dalin t'i
9 mbledhin të lashtat, të korrat e vjeshtës, është marrë Ramiz
10 Hoxha.

11 PY. Atëherë bëjmë një pauzë këtu për një çast. Po flisni për
12 të folurin me serbët, domethënë për sa i takon të korrave të
13 vjeshtës. A mund të na thoni se çfarë roli ka pasur Ramiz
14 Hoxha sa i takon këtyre diskutimeve, Dëshmitar?

15 PË. Ka qenë vetëm përkthyesi i atyne përfaqësuesve të fshatit
16 për arsye se Ramiz Hoxha ka jetue në Slloveni dhe e ka njoft
17 edhe gjuhën serbe.

18 PY. Nga e dini që Ramiz Hoxha ka pas këtë rol, domethënë që
19 ka qenë përkthyesi sa i takon këtyre bashkëbisedimeve?

20 PË. Këto e thonë edhe banorët e fshatit, por konkretisht
21 vëllavi i Ramizit dhe djali i tij.

22 PY. Ju thatë që ata kishin shku në fushë për të bë punën. A
23 do të thotë kjo që ishte arritur një lloj marrëveshje me
24 autoritet serbe në mënyrën të tillë që të mund të ndodhte puna
25 e të korrurave?

1 PË. Po, dhe flitet që udhëheqësit ushtarakë serbë kanë
2 kërkuar që mos të jetë e përfshirë pjesa e uniformuar e
3 Ushtrisë Çlirimtare në atë zonë ku kanë qenë banorët.

4 PY. Gjithashtu keni thënë që atë e kanë marrë. A e dini që
5 atë e kanë marrë, domethënë, si rezultat i asaj çka të kanë
6 thënë personat e tjerë që kanë qenë pjesë e bisedave për
7 korrjet, çfarë do të thotë që ka qenë vëllai i Ramiz Hoxhës
8 dhe djali i tij, këta ta kanë thënë, kështu e di, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Atëherë, sa për t'u sqaruar, dhe për të qenë të qartë
11 lidhur me këta persona, a mund të na jepni emrat e këtyre
12 personave? Vëllai, si e ka pas emrin, si e ka emrin?

13 PË. Vëllai s'më kujtohet, a djali, Fadil. Është një shok i
14 imi.

15 PY. Në rregull. Sa kohë kishte kaluar prej këtyre negociatave
16 ose këtyre bashkëbisedimeve, kur e kanë marrë Ramiz Hoxhën?

17 PË. Pas tri ditëve.

18 PY. Këta personat që të kanë thënë ty që e kanë marrë atë,
19 domethënë, djali i tij Fadili dhe vëllai i tij, këta dy
20 persona kanë qenë të pranishëm kur e kanë marrë Ramiz Hoxhën,
21 Dëshmitar?

22 PË. Vëllau po, Fadili jo, se përse në atë kohë ishte me mu në
23 Slloveni, ishte, në atë kohë, në Slloveni.

24 PY. Nga ajo çfarë ju kanë thënë këta persona, na përshkruani
25 ju lutem se si e kanë marrë Ramiz Hoxhën.

1 PË. Thuhet që ata kanë shku në xhaminë e fshatit ku ka qenë
2 duke u kryer rituali ditor dhe kanë kërkuar hoxhën e fshatit.
3 Dhe Ramizi del aty dhe ju thotë që "unë kam qenë përkthyesi në
4 atë takim, dhe çka të keni mund t'jua shpjegoj unë". Personat
5 e maskuar e kanë marrë Ramiz Hoxhën i kanë thanë duhet të
6 vijsh me ne.

7 PY. Po më pas, çfarë ndodhi?

8 PË. Flitet që ka kërkuar të shkojë edhe vëllai i tij me të.
9 Por ata i kanë thanë që ti s'mundesh të vjen.

10 PY. A mund të na thoni se ku gjendet kjo xhamia, në çfarë
11 qyteze, apo në çfarë fshati gjendet xhamia?

12 PË. Gjendet në fshatin e Ramizit, fshatin Bellanicë, mu në
13 mes të fshatit.

14 PY. Thua që ai, e kam fjalën që -- kam përshtypjen që e keni
15 fjalën për Ramiz Hoxhën, i kërkoi të vëllait që të shkonte me
16 të, por ai tha që vëllai nuk shkonte dot me të. Po pastaj
17 çfarë ndodhi pas kësaj, Dëshmitar?

18 PË. Me mu -- kanë marrë Ramizin dhe ata janë largu nga
19 xhamia.

20 PY. Si janë largu me të?

21 PË. Po thuhet që e kanë fut në bagazhin e makinës dhe, kur ka
22 kërkua vëllai të shkoj me të, thanë s'ka vend për ty.

23 PY. A e dini në qoftë se kjo makina ka qenë e UÇK-së, ka qenë
24 veturë e UÇK-së, apo jo?

25 PË. Flitet që po, se përse njerëzit kanë qenë të maskuar?

1 PY. A ka pasur ndonjë shenjë në veturë që tregonte që ishte
2 veturë e UÇK-së, Dëshmitar?

3 PË. Unë s'e di, por thuhet që po.

4 PY. Kur thua që "thuhet se po", çfarë thuhet se ka pasur si
5 shenjë dalluese në veturë?

6 PË. Nuk flitet saktë a ka pas diçka shenja tabelë, apo shenja
7 dalluese, veç thonin se ka qenë me shenja të UÇK-së.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoja
9 që të kalonim në seancën -- në Shënimin Përgatitor 2,
10 paragrafi 34 për të parë në qoftë se ka ndonjë mungesë
11 konsistence këtu.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
13 mund të vazhdoni.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitar, në seancën përgatitore
15 përpara një jave, ju thatë që janë hedhur në një makinë që
16 kishte shenjën ose emblemën e UÇK-së. A kishte një emblemë të
17 UÇK-së kjo makina, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Simbas atyne që tregojnë, po.

19 PY. Dhe këtu përfshihej edhe vëllai i Ramiz Hoxhës, që ka
20 qenë aty në vendin kur ka ndodhur kjo, këtë ta ka thënë edhe
21 ai, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. A e kanë vënë ndonjë person tjetër brenda në makinë së
24 bashku me Ramiz Hoxhën, Dëshmitar? Te bagazhi e kanë futur
25 bashkë me të ndonjë person tjetër?

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju
2 ndërpres, por ju lutem na thoni burimin.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kam thënë
4 në mënyrë të vazhdueshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, është
6 thënë.

7 Z. HALLING: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, dëshironi që t'jua them edhe një herë pyetjen?

9 PË. Po, përsërite.

10 PY. Në bagazh të makinës, a ka pas ndonjë njeri tjetër bashkë
11 me Ramiz Hoxhën?

12 PË. Po. Thuhet që ka qenë një tjetër njeri në të, dhe ai
13 është gjetur i vdekur bashkë me Ramizin.

14 PY. Kush ishte?

15 PË. Por ma vonë del të jetë Binishi mbiemri, s'po më
16 kujtohet, më fal.

17 PY. Po emrin, e kujton dot?

18 PË. E kam dit, por për momentin s'po më kujtohet.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
20 kërkonim leje t'i rifreskonim kujtesën dëshmitarit, për të
21 njëjtin paragraf, është paragrafi 34 i Shënimit përgatitor
22 numër 2.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, javën e kaluar kur kishim seancën përgatitore

1 ti the që:

2 "Nja 5 a 6 ditë pasi u arrit marrëveshja për të korrat,
3 Ramiz Hoxha dhe Selman Binishin që ishin në një shitore aty
4 pranë, i morën nga xhamia e Balincës disa persona që kishin
5 marrë maska."

6 Të kujtohet tani emri i atij personit, mos e kishte
7 Selman?

8 PË. [E padëgjueshme].

9 PY. Mund të përsërisni dhe një herë, ju lutem?

10 PË. Po, te përkthimi përmendet fshati Balincë, por është
11 Bellanicë, jo Balincë. Dhe po, personi me emër është Selman
12 Binishi, të cilin nuk e kam njoft.

13 PY. Ky personi ka qenë në një shitore aty pranë kur e morën?

14 PË. Po.

15 PY. Pasi i morën këta personat, Ramiz Hoxhën dhe Selman
16 Binishin, çfarë ndodhi?

17 PË. Mbas dhjetë minutave thuhet që janë gjet të vdekur buzë
18 rruge.

19 PY. Me përafërsi, sa larg prej xhamisë u gjetën trupat, nëse
20 e dini?

21 PË. Mund të hamendësoj, por një kilometër, mos të themi
22 përmbi dy, larg xhamisë.

23 PY. Kush i gjeti trupat? Dhjetë minuta, thua ti, mbasi i
24 kishin marrë.

25 PË. Djali i Ramizit dhe një bashkëfshatar i tij.

1 PY. Këta personat që të treguan ty për këtë ngjarjen, a thanë
2 edhe ndonjë gjë tjetër se si ishin vrarë Ramiz Hoxha dhe
3 Selman Binishi?

4 PË. Jo, vetëm që thojnë që i kanë gjetur, si të thojnë, në
5 çastet e fundit, domethënë, pak minuta përpara janë vra.

6 PY. Ti ke thënë që Ramiz Hoxha në fakt ka qenë thjesht
7 përkthyes për këto të korrat e vjeshtës. Por a ishte Ramiz
8 Hoxha kolaboracionist i serbëve?

9 PË. Për mua, jo. As atëherë, as sot.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari
12 flet dhe për ndalime e vrasje të tjera në intervistën e 2019-s
13 edhe është ballafaquar veçanërisht për të burgosurit meshkuj
14 në Malishevë në materialin sipas rregullës 154. Kjo është
15 tashmë pjesë e provave gjyqësore. Ne nuk kemi pyetje të tjera.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Laws.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Po, edhe unë kam disa pyetje për këtë
19 dëshmitar. Por me sa di unë, ka kundërshtime nga Mbrojtja e
20 Thaçit. Nuk jam i sigurt nëse duhet të trajtohet një herë
21 kundërshtimi përpara se të vijojmë pyetjet e mia.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin e protokolluar
24 F02470 dhe F02561, Mbrojtësi i Viktimave bëri me dije se
25 dëshiron që t'i bëjë pyetje dëshmitarit sa i takon ofensivës

1 së UÇK-së kundër Rahovecit në korrik të 1998, fatit të këtyre
2 personave, vendndodhjeve edhe -- të vendndodhjeve të trupave.
3 Këto janë çështje me rëndësi të madhe sidomos për numrin e
4 viktimave pjesëmarrjes në këtë çështje gjyqësore.

5 Dhe Trupi Gjykses mendon që, pra Trupi Gjykses është i
6 bindur se për kundërshtim me atë që thotë Mbrojtja me
7 parashtrimet e veta, Trupi Gjykses mendon se pyetjet e
8 Mbrojtësit të Viktimave janë të rëndësishme për këtë
9 dëshmitar, siç janë evidentuar në parashtrimin F02470, F02561,
10 sepse lidhen drejtpërsëdrejti me interesat e viktimave
11 pjesëmarrësve në procesin gjyqësor.

12 Trupi Gjykses vëren më tej se dosjet A dhe B të aktakuzës
13 rendisin disa viktima të vrasjes dhe të ndalimit arbitrar në
14 vendet që lidhen me pyetjet e Mbrojtësit të Viktimave.

15 Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin e
16 vet, Mbrojtësi i Viktimave ka thënë që ka të paktën tri
17 viktima me status të dyfishtë për të cilat është me interes që
18 të bëhen pyetjet, dhe Mbrojtja e di që është me interes dhe
19 nuk ka asnjë cenim për ta.

20 Trupi Gjykses është i mendimit që nuk është nevoja për të
21 nxjerrë në fakt emrat e viktimave të tjera në këtë proces
22 gjyqësor, sepse ne nuk duam që të nxjerrim të dhënat e tyre
23 identifikuese.

24 Trupi Gjykses vëren se të pandehurit kanë të drejtën të
25 bëjnë kundërpvetjet e veta, kur t'u vijë radha, Dëshmitarit

1 04278, dhe kanë pas kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për
2 kundërpjetjet që do kenë në vijim të pyetjeve të Mbrojtësit të
3 Viktimave.

4 Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes dhe pranon
5 kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për t'i bërë pyetje
6 dëshmitarit 04278.

7 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

8 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

9 Z. LAWS: [Përkthim]

10 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Simon Laws, jam Avokati i
11 viktimave në këtë çështje gjyqësore. Unë përfaqësoj personat
12 të cilëve u janë vrarë të afërmit, pasi janë mbajtur të
13 ndaluar në Malishevë në verën e 1998-s. E kuptuat?

14 PË. Po.

15 PY. Të kthehemi pas në kohë, në verën e këtij viti në
16 Malishevë. Ju asokohe e quanit zonë e lirë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Kur thoni zonë e lirë, ju e kishit fjalën që atje
19 s'kishte serbë dhe se ishte në kontrollin e UÇK-së, kështu?

20 PË. S'kishte forca serbe, saktë.

21 PY. Dhe ishte nën kontrollin e UÇK-së, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Kemi dëgjuar përshkrime se si kafenetë e restorantet
24 ishin të hapura, dhe ushtarët e UÇK-së shkonin në qytezë për
25 t'u relaksuar, për t'u takuar me shokët e tyre, për të pirë

1 ndonjë kafe bashkë, kështu?

2 PË. Mund të jetë dhe ashtu. Mund të kenë qenë.

3 PY. Pra, ishte një vend tërheqës për komunitetin shqiptar.

4 Ishte një vend ku të paktën, më së paku, atje ndjeheshit disi
5 të lirë, kështu?

6 PË. Dhe mund të furnizohen me gjësende të cilat dojshin.

7 PY. E kuptoj. Por nuk ishte vend i sigurt për serbët, apo jo?

8 PË. Nuk kishte serbë, banues serbë në atë kohë në Malishevë.

9 PY. Po, nuk ka pas banorë serbë, ashtu është. Por ama ju e
10 dini që atje i sollën disa serbë, apo jo?

11 PË. Unë nuk e di, përjashtim një familjes që unë kam pas të
12 boj me ta që e ka sjellë dikush, serbë, në Malishevë.

13 PY. Familja për të cilën po flisni ju është familje serbësh,
14 apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Domethënë, ju e dini që në Malishevë kanë sjellë serbë në
17 korrik të 1998-s, apo jo?

18 PË. E di për atë familjen, për arsye se unë jam kontakti i
19 parë me të.

20 PY. Po. Pra, për serbët nuk ishte vend i sigurt, apo jo?

21 PË. Unë mendoj që ka qenë i sigurt për serbët civilë, për
22 forcat serbe jo.

23 PY. Po meshkujt serbë? Do ishte vend i sigurt për një grup
24 meshkujsh serbë të vinin në Malishevë të uleshin të pinin një
25 kafe edhe të hynin në muhabet me ushtarët e UÇK-së? A do ishte

1 i sigurt ky veprim?

2 PË. Sigurisht, të ishin banorë të Malishevës ata, dhe të mos
3 ishin të impliku në krime, sigurisht që po, do të ishte dhe
4 për ta vend i hapur për, si për të gjithë ne.

5 PY. Ju sapo thatë pak më përpara që nuk ka pasur banorë -- më
6 fal, sapo thatë që nuk ka pasur banorë serbë në Malishevë, në
7 atë kohë? Kështu?

8 PË. E saktë. As në atë kohë, por asnjherë. Me përjashtim të
9 fshatit Kievë.

10 PY. A mund të themi që për të gjithë ishte e qartë që të
11 sillje serbë në Malishevë, ky veprim i rrezikonte këta,
12 kështu?

13 PË. Nuk mendoj ashtu.

14 PY. Ju nuk mendoni ashtu?

15 PË. Jo, për arsye se kemi fakte të kësaj familje serbe dhe
16 ajo jep deklarata të saj si jemi sjellë ne me ta.

17 PY. Familja serbe për të cilën po flisni ju, pra këtë familje
18 ti e ke çuar në një vend ku ti shpresove që nuk do të shkonin
19 ushtarët, apo jo? E çove në një vend ku shpresove që nuk do
20 shkonin ushtarët, apo jo?

21 PË. Jo ushtarët, por kisha dëshirë që të ndihen ata sa më të
22 qetë e më të relaks, për arsye se ishin traumatizu me atë që
23 kishin përjetu në Rahovec.

24 PY. Mos më keqkuptoni, ju lutem. Nuk kam, nuk kam ardhur këtu
25 t'ju akuzoj. S'ju akuzoj për asgjë. Thjesht unë dua që të

1 ndihmoni ju pak me atë çka ndodhur asokohe, më kuptoni?

2 PË. Nuk ju keqkuptoj. Unë sapo e bana një betim që do ta them
3 vetëm atë që di dhe që jam i sigurt.

4 PY. Mirë, të shohim diçka që keni thënë në intervistën në
5 2019.

6 Z. LAWS: [Përkthim] Mund të vendosim në ekran Pjesën 3 të
7 intervistës që është me numër 059666-TR-ET. Ju lutem, faqen 4
8 dhe në anglisht dhe në shqip. Anglishtja fillon tek rreshti 9,
9 ndërsa në shqip pak më poshtë tek rreshti 20 -- 22.

10 PY. Në ekran është një pjesë e intervistës që keni dhënë ju
11 vetë. Unë do t'ju lexoj diçka, një pjesë të asaj që i keni
12 thënë, për këtë familjen.

13 "Edhe thirra rojën në shtab që ishte poshtë, e i thashë,
14 'E ki obligim me ruajt te dera që të mos hyjë kurrkush pa u
15 kthy unë'."

16 Pastaj keni thënë që keni shkuar në shtëpi, për t'u
17 ndërru, dhe pastaj e vazhdoni:

18 "I thashë rojës që askush nuk do të hyjë në dhomë, i
19 thashë grave që i vetmi person me të cilin do të merreshin,
20 isha unë."

21 Sipas teje, ose të paktën ishte përshtypja jote se ato
22 ishin në rrezik dhe për këtë arsye duhet të bëje organizimet
23 të duhura në mënyrë që të mos u bëhej asgjë atyre?

24 PË. Po. Kur e dimë faktin që në atë kohë ishin kry shumë
25 masakra, krime, serbe ndaj popullatës civile, dhe në rrethinën

- 1 e Malishevës, dhe unë u frigohesha që dikush që ka pësu
2 familja e tij, mund të hakmerret. Kjo ishte arsyeja.
- 3 PY. Po. Dhe kjo lidhet me pyetjen që bëra një çikë më
4 përpara, dhe do ta bëj dhe një herë pyetjen. Domethënë, të
5 çoje serbët në Malishevë a ishte diçka që u rrezikonte jetën?
- 6 PË. Po ishin serbë të panjoftun, ishin nga treva që ne s'i
7 njifnim.
- 8 PY. Po nuk është tamam përgjigjja e pyetjes sime kjo. Pyetja
9 ime është e thjeshtë. Domethënë, të çoje serbë në Malishevë në
10 korrik të 1998-s, a nuk i vendosje në rrezik me këtë gjë?
- 11 PË. Për mua, jo.
- 12 PY. Në rregull. Tani, e dini ju që në fakt disa meshkuj serbë
13 që i kanë çuar në Malishevë, më pas i kanë larguar dhe i kanë
14 vrarë. Këtë e dini tani, apo jo?
- 15 PË. E kam dëgjuar nga Prokuroria, por jo, asnjëherë më parë.
- 16 PY. Po thoni që e keni mësu për herë të parë në 2019-n, kur
17 ju ka intervistuar ZPS-ja?
- 18 PË. Po, për arsye kanë qëndru në Malishevë, vetëm nga ZPS-ja
19 e kam dëgju, kurrë përpara.
- 20 PY. S'e kishit dëgjuar ndonjëherë më përpara? Po ju i keni
21 thënë Prokurorisë se kishit lexuar artikuj, kishit parë lajme
22 që kishin zhvarrosur trupa, ishin zhvarrosur trupa. Dhe thatë
23 që nuk, trupat s'ranë nga qielli. As duke parë lajmet s'e
24 kishe të qartë që --
- 25 PË. E kisha të qartë ---

1 PY. -- ja një çast, ju lutem. Të mbarojmë pyetjen. Pra, nuk e
2 kishit të qartë ju që këta serbë ishin mbajtur në Malishevë,
3 më pas i kishin larguar nga Malisheva dhe i kishin ekzekutuar,
4 likuiduar?

5 PË. Asnjëherë s'e kisha dëgjuar për këtë që kanë qëndruar në
6 Malishevë. A pse janë gjetur të vrarë, po.

7 PY. Kur e mësove për herë të parë dhe sipas teje, kjo ka
8 ndodh në 2019-n, se ky është viti kur ke dhënë intervistën për
9 ZPS-në, atëherë i takon të jesh, të kesh ngelur pa fjalë kur
10 ke mësuar që disa burra që janë mbajtur të ndaluar në qytezën
11 ku keni qenë ju polic ushtarak, më pas ishin vrarë. Për ty do
12 të ketë qenë një lajm i tmerrshëm ky, apo jo?

13 PË. S'ka qenë lajm i tmerrshëm. Është një lajm që s'e besoj
14 edhe sot që ka qëndru dikush në Malishevë edhe mos të jetë fol
15 shumë vite ma herët para 2019-s. Po s'e besoj atë.

16 PY. Që të jemi të qartë që po kuptohemi. Ti po thua që nuk
17 pajtohesh me faktin që janë mbajtur disa burra të ndaluar në
18 Malishevë, të cilët u zhvarrosën më pas, trupat e tyre, dhe që
19 kanë qenë ushtarë të UÇK-së [Sipas përkthimit], ju nuk e
20 besoni këtë?

21 PË. Edhe një herë përkthimi, se dallim i madh mes ato që po
22 thotë edhe atë që po përktheni.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përsërisni --
24 përsërisni dhe një herë pyetjen.

25 PËRKTHYESI: Atëherë, që të kuptohemi, po thoni ju që nuk

1 pajtoheni me faktin që në Malishevë janë mbajtur të ndaluar
2 burra, të cilëve iu gjetën trupat më pas, dhe iu zhvarrosën,
3 dhe se këta burra ishin të burgosur serbë të UÇK-së? Këtë nuk
4 besoni?

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. A e dëgjuat edhe një herë përkthimin?

7 PË. Po.

8 PY. A e keni të qartë pyetjen --

9 PË. Po.

10 PY. -- a doni t'i përgjigjeni?

11 PË. Po. Nuk e besoj. Dhe s'e kisha dëgjuar asnjëherë që këta
12 burra janë mbajtur në Malishevë. Për pjesën ku gjinden, ka qenë
13 përmes mediave dhe atëherë e kam kuptuar që janë gjetur viktima
14 serbe të vrarë. Nga kanë ardh, për atë kam thanë s'kanë pikë
15 nga qielli, se parafrazoj çfarë kam thanë në 2019-n.

16 PY. Në rregull. Nuk dua që të flasim shumë për këtë pjesën se
17 kur ke dëgjuar për herë të parë. Nuk është kjo pjesa më e
18 rëndësishme, por do t'ju lexoj diçka nga Pjesa 3 e
19 intervistës.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Është në faqen 26, rreshti 24.

21 PY. Ju ka bërë pyetje Prokuroria, nëse kishit dëgjuar më
22 përpara për këtë gjë, dhe ju keni thënë:

23 "Asnjëherë deri në momentin që u gjetën viktimat në
24 territorin e Klinës. Dhe kështu filluan të flisnin njerëzit
25 pastaj, që këta persona kishin qenë të mbajtur në Malishevë,

1 por më përpara s'e kisha dëgjuar asnjëherë."

2 Pra, me sa e kuptojmë ne, ju në 2019-n keni thënë që, po,
3 kishit dëgjuar ju më përpara që ishin mbajtur të ndaluar këta
4 persona në Malishevë. A na ndihmoni pak pse e kemi një
5 mospërputhje këtu?

6 PË. Që janë mbajtur në Malishevë, s'e kam dëgjuar. Pse janë
7 gjetur viktima trupa serbe, po.

8 PY. Por ama s'e ke thënë këtë në 2019. Por mos të çojmë më
9 kohë dëm.

10 Kur ta treguan këtë gjë në 2019, ti po thua që nuk e
11 besove ZPS-në? Pra ti s'e besove atë që tha ZPS-ja se ishin
12 mbajtur të ndaluar persona në Malishevë, që më pas u gjetën të
13 vdekur, këtë po thoni?

14 PË. S'e besoj as sot. Se sikur të kish ndodhur do ta kisha
15 dëgjuar.

16 PY. Kur e dëgjove këtë gjë, prej Prokurorisë, pra, në 2019-n,
17 a pyete ti ish-kolegët për këtë gjë? A u interesove me ish-
18 kolegët për këtë gjë? E kemi fjalën, ish-kolegët në policinë
19 ushtarake.

20 PË. Asnjë prej pyetjeve që m'u kanë parashtrur nga Prokurori
21 në 2019-n s'i kam komentu as me shokë as me anëtarë të ngushtë
22 të familjes time, se ashtu më është sugjeruar nga Prokuroria.

23 PY. Atëherë, ajo që ka -- që keni thënë në 2019-n është me
24 rëndësi, se ju keni thënë që kishit dëgjuar më përpara për
25 burra që ishin mbajtur të ndaluar në Malishevë. Po sidoqoftë,

- 1 unë dua të jemi të qartë për një gjë. Jakup Hotin, për
2 shembull, e ke pyetur ndonjëherë ti nëse ishin mbajtur të
3 ndaluar meshkuj serbë në Malishevë të cilët më pas u vranë?
4 PË. Asnjëherë s'e kam pyetur.
- 5 PY. Po Haxhi Shalën, e ke pyetur ndonjëherë? A janë mbajtur
6 meshkuj serbë në Malishevë dhe më pas janë vranë?
7 PË. Haxhi Shalën s'kam pas rastin ta pyeti, për arsye se kena
8 pas dallime edhe në luftë, edhe pas lufte në politikë. S'kam
9 rast.
- 10 PY. Po Isni Kilaj, e ke pyetur ndonjëherë lidhur me këtë?
11 PË. Jo.
- 12 PY. E keni shok, apo jo?
13 PË. E kam deri dikund, politika na ka ndarë.
- 14 PY. Po e ke aq shok të paktën sa ta pyesësh, ore a ke dëgjuar
15 ndonjëherë për ca burra që janë ekzekutuar pasi kanë qenë nën
16 ndalimin e policisë ushtarake në Malishevë?
17 PË. Nuk është në etikën time të marr informata dhe të pyes
18 për gjana koti që mu s'më përkasin.
- 19 PY. Po pse janë pa kuptim këta, na thuaj?
20 PË. Për mua janë pa kuptim këta se s'përkojnë kurrëgjë, asgjë
21 me jetën tem, punën tem, dhe për këtë.
- 22 PY. A e ke kuptuar vetë ndonjëherë ti, të paktën sipas teje,
23 ose më saktë, ti si e kuptuar pse i sollën këta persona në
24 Malishevë UÇK-ja?
25 PË. E kuptoj insistimin tuaj, por unë them se s'kam dëgjuar.

1 Si ta kem kuptuar, si [E pakuptueshme] unë di të flas për atë
2 ça kam pas të bëj unë.

3 PY. Atëherë do flasim për diçka ku keni qenë ju i përfshirë.
4 Keni folur vetëm për një familje me të cilën jeni marrë ju. A
5 e kuptove ndonjëherë ti pse e sollën këtë familjen në
6 Malishevë, cili qe qëllimi?

7 PË. Nuk din askush se si kanë depërtu dhe si janë sjellë ata
8 në Malishevë. E kam thanë edhe në intervistën time, që edhe
9 roja e shtabit që ishte në Malishevë nuk i ka njoft personat
10 të cilët i sollën, për arsye se ato ditë kishte luftime në
11 Rahovec, dhe të gjithë banorët e Rahovecit lëvizën nga
12 Rahoveci.

13 PY. Me gjithë respektin, nuk është rasti që askush tjetër nuk
14 e dinte, sepse ju i keni thënë ZPS-së që ata janë dërguar atje
15 nga UÇK-ja. Kaq e ke ditur, Dëshmitar, apo jo?

16 PË. Po ashtu kanë thanë ato që i kanë sjell kur kam
17 bashkëbisedu me to. Thotë, "njerëz të uniformuar të UÇK-së na
18 kanë sjellë". Aq.

19 PY. Po. Ekzaktësisht kështu. Pra, nuk është se ka qenë se
20 askush nuk e ka ditur, ka pasur ca njerëz në UÇK- që e kanë
21 ditur arsyen se pse këta civilë janë dërguar në Malishevë. Dhe
22 pse ishin ndarë nga burrat që më pas janë marrë dhe janë
23 vrarë. Dikush e dinte, ca i dinin se pse i kishin marrë, apo
24 jo?

25 PË. Unë nuk e dija.

1 PY. Unë nuk po ju pyes në qoftë se e dinit ju apo jo, por po
2 ju pyes që mbështetur në atë çfarë na thatë përpara pak
3 çastesh, që e thatë që askush nuk e dinte, unë po ju pyes në
4 qoftë se pajtoheni me mua, që dikush e dinte. Kjo është e
5 kuptueshme, është e qartë nga fakti që sikurse e keni thënë
6 dhe vetë UÇK-ja i kishte çuar ata atje.

7 PË. Kam interpretuar fjalët që kanë thanë ato. Se ato më
8 thanë që UÇK-ja na ka sjellë këtu.

9 PY. Gjithë këto vite kanë kaluar që prej atëherë, gjatë kësaj
10 periudhe, ju nuk jeni përpjekur asnjëherë që të dini më tepër
11 se pse UÇK-ja i ka marrë ata persona atje?

12 PË. Po së pari, s'ka përku, thash, me profesionin dhe punën
13 time. Sikur të isha një hetues, një gjyqtar, sigurisht që
14 duhet të interesohena. Por unë jam një bujk, dhe merrem me
15 problemet e mia ditore.

16 PY. Pra, përgjigja për pyetjen është jo --

17 PË. Jo.

18 PY. -- Që asnjëherë nuk je përpjekur që të marrësh vesh çfarë
19 ka ndodhur? Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. Tavakoli, fjala për ju.

22 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, zotëri. Unë quhem Nina Tavakoli dhe jam avokate
25 e Hashim Thaçit. Do t'ju bëj disa pyetje në emër të tij.

1 Së pari, dua t'ju pyes lidhur me rritjen e UÇK-së në
2 1998-n. Kur keni folur me ZPS-në në vitin 2019, dhe për
3 procesverbal referenca është P01694.7, faqet 4 deri në 5, ju
4 jeni pajtuar me të që UÇK-ja u rrit në mënyrë domethënëse pas
5 sulmit të serbëve në kompleksin e Jasharëve në vitin 1998. A
6 ju kujtohet t'ia keni thënë Prokurorisë këtë, Dëshmitar?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Përpara një jave, i thatë Prokurorit, kjo jepet në
9 Shënimi Përgatitor numër 1, paragrafi 38, që ai sulm ka
10 krijuar panik nëpër Kosovë, në fshatrat përreth në Kosovë. A
11 është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, po, panik për sulme të tjera në familje të tjera.

13 PY. Kush mendonin ata që do ishte sulmues, kush do i sulmonte
14 ata?

15 PË. Forcat serbe, të cilat ishin vendosur gjithandej Kosovës.

16 PY. Pra, ekzistonte shqetësimi që forcat serbe do sulmonin
17 civilët shqiptarë, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. I keni thënë ZPS-së, për procesverbal këtë e keni thënë
20 në Shënimin Përgatitor, paragrafi 38, që për shkak të këtij
21 paniku ata janë organizuar, janë vetëorganizuar. Kështu keni
22 thënë ju me fjalët tuaja. Pastaj ju vazhdoni dhe i shpjegoni
23 ZPS-së se si janë vetëorganizuar. Dhe për referencë, për
24 procesverbal, këtë e keni thënë në P01694.7, në faqen 4, keni
25 thënë si më poshtë dhe këtu citoj: "Çdo fshat ka ruajtur

1 hyrjet e veta, në veçanti fshatrat që kanë pasur serbë që
2 jetonin aty pranë, dhe njerëzit filluan që të paraqiteshin një
3 herë duke përdorur armë gjahu së pari" -- a ju kujtohet ta
4 keni thënë këtë, Dëshmitar?

5 PË. Saktë.

6 PY. Kishin armët e veta personale këto për të cilat e keni
7 fjalën ju?

8 PË. Po.

9 PY. A do të kisha të drejtë unë po të thoja që Kosova ka qenë
10 shumë me, ka qenë goxha e përhapur përdorimi i armëve në
11 kuptimin që në Kosovë shumë veta kishin armë. A është e drejtë
12 kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, dhe mund ta shpjegoj nëse më lejoni pse.

14 PY. Po, vazhdoni.

15 PË. Për arsye se, sidomos prej vitit 1990, kur u shpërbënë
16 institucionet tona dhe u përjashtun nga puna punëtorët tonë,
17 gjithmonë jena ndi të friguar dhe kena pas maltrajtime nga ana
18 e pushtetit të atëhershëm në Kosovë. Dhe për këtë arsye, për
19 të mbrojt familjen, kena interesu rrugëve ilegale të sigurojmë
20 armë për vetëmbrojtje të familjeve, jo ma gjerë.

21 Dhe mbi të gjitha, në periudhën e viteve 1990, regjimi
22 serb filloi t'i armatosë të gjithë anëtarët serbë të moshës
23 madhore që nënkupton mbi 18 vjeçar, kanë qenë të armatosur.
24 Dhe çdo rast u frigojshin që do të kemi, mund të kemi sulm nga
25 forcat serbe, t'i përfshinin edhe civilët serbë që ishin të

1 armatosur.

2 PY. Pra, juve keni siguru armë për arsye vetëmbrojtje,
3 kështu, Dëshmitar?

4 PË. Saktë.

5 PY. Sa i takon këtij lloji organizimi që ka ndodhur, po ashtu
6 i keni thënë ZPS-së dhe për procesverbal referenca këtu është
7 P01694.7, në faqet 4 deri në 5, në fjalët tuaja ju keni thënë
8 kështu:

9 "Nuk është se ishte organizim i përgjithshëm, por çdo
10 fshat kujdesej për fshatin e vet. Unë kam qenë një ndër
11 personat e parë që kanë organizuar gjërat për fshatin tim."

12 Përmes kësaj çfarë keni thënë, Dëshmitar, a keni dashur
13 të thoni që çdo fshat është organizuar për të -- mbrojtur
14 fshatin përkatës, domethënë, dhe organizimi ishte nga fshati
15 vetë, nuk është se ka qenë organizim nga lart-poshtë, por ka
16 qenë nga baza e fshatit të vet. A e kam kuptuar saktë këtë?

17 PË. Saktë. Nga baza e fshatit, dhe kjo ndodhi në
18 kujdestaritë, sidomos natën prej vitit 1991-1992. Atëherë kena
19 fillu të kujdestarojmë fshatin natën.

20 PY. Gjithashtu i keni thënë Prokurorisë përpara një jave, dhe
21 referenca këtu është Shënimi përgatitor, paragrafi 38, që në
22 zonën tuaj ata filluan të organizoheshin dhe të bënin roje
23 gjatë natës. Thatë gjithashtu që strukturat e para u
24 organizuan nga LDK-ja.

25 A mund të na e shpjegoni pak, Dëshmitar, çfarë keni

1 dashur të thoni me këtë?

2 PË. Thoj me këtë, atëherë e vetmja parti me aktivitetin e saj
3 e cila ishte e shtri në të gjitha fshatrat e Kosovës, ishte
4 Lidhja Demokratike, dhe ndër këto mbledhjet e Lidhjes
5 Demokratike në qendër u merr vendim që me pas kujdes për arsye
6 të armatosjes edhe të civilëve serbë. Që dhe kjo ishte arsyeja
7 që ne vetë kemi kujdestaru nëpër fshatra.

8 PY. Faleminderit. Tani dua të flasim lidhur me rolin tuaj
9 brenda UÇK-së. Ju jeni kyçur në UÇK në prill të 1998, apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Fillimisht ju keni ndihmuar mjekët që të shkonin nga një
13 vend tek tjetri duke i vozitur ata sepse ju kishit një veturë
14 vetë, kështu, Dëshmitar?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. A do kisha të drejtë të thoja që ju i keni ndihmuar
17 mjekëve që të shkonin nga një vend te tjetri në mënyrë që të
18 mund të kuronin shqiptarët e plagosur? A është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. I keni thënë ZPS-së, dhe për këtë referenca është
21 P01694.1, faqja 9, që nuk i keni raportuar askujt sepse nuk
22 kishit kujt t'i raportonit. A është e saktë kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Gjithashtu keni thënë që ju nuk kishit hierarki në atë
25 kohë, apo jo? Në atë kohë.

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 82

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, na sqaroni çfarë do me
2 thënë "në atë kohë"?

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në prill të 1998-s.

4 DËSHMITARI: Po. Mund ta spjegoj?

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

6 PY. Po.

7 PË. Derisa ishim të vetëorganizuar, atëherë nuk kishim edhe
8 përgjegjësi për t'i raportuar dikujt më lart, por ishim ata të
9 cilët kishim bashkëpunu njani me tjetrin dhe vendoshim ne si
10 individë. Kjo është e saktë.

11 PY. Pra, ky ishte një organizim fshat për fshat, domethënë
12 ishte një organizim i brendshëm i fshatrave, kështu, apo jo?

13 PË. Fillimet e para, saktë, kështu. S'ka pas komunikim as me
14 fshatrat e tjera, por fshat për fshat. Sidomos ne që ishim
15 zona malore.

16 PY. Po sepse nuk është se ka pas pajisje komunikimi, kështu?

17 PË. Ato, e kemi përfundu luftën edhe s'kemi pas pajisje
18 komunikimi, leje ma atëherë.

19 PY. Ju ishit të gjithë vullnetarë që po mundoheshit që të
20 ndihmonit me sa mundeshit, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Në qershor të vitit 1998 ju bëheni pjesë e policisë
23 ushtarake në zonën tuaj, a është e saktë kjo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe ishit tre veta, Tahir Ulluri, Jakup Hoti dhe ti vetë,

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 83

1 apo jo?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. I keni thënë ZPS-së, dhe referenca për këtë është
4 P01694.1, faqja 15, që midis jush ju jeni pajtuar që Hoti do
5 ishte drejtuesi, keni thënë që ju nuk është, domethënë askush
6 nuk e ka emëruar atë në atë pozicion, por ju u pajtuat me
7 njëri-tjetrin që atë ta kishit si drejtues, kështu?

8 PË. Mund ta shpjegoj?

9 PY. Po.

10 PË. Për arsye se te ne mbizotëron, edhe në traditën tonë,
11 edhe në familje, i moshuari t'i ketë përparësitë. Mixha, tha,
12 Jakup Hoti ishte ma i vjetri se ne, dhe ishte ma i përgatitun
13 për arsye që kish kry shkollën ma herët, punonte,
14 bashkëvepronte, edhe na i dhamë besimin vetë. Të them të
15 drejtën, ish kërkun nga unë si jurist që të jem unë udhëheqës i
16 policisë ushtarake, por për respektin që kam pas dhe sot e kam
17 për Jakup Hotin, jemi dakordu që ai të jetë si udhëheqësi i
18 joni, edhe të na këshillojë edhe të na udhëzojë.

19 PY. I keni thënë ZPS-së po ashtu, dhe për këtë referenca
20 është prova P0169.2 [Sipas përkthimit], keni thënë që nuk e
21 dini se kujt i ka raportuar Jakup Hoti, në qoftë se i ka
22 raportu ndonjërit. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po. S'ka qenë rregull të raporton, se këtu raportet janë
24 bo vetëm brenda neve të treve për atë periudhë.

25 PY. Në atë kohë ju nuk keni marrë pjesë në takime të nivelit

1 të lartë që kanë ndodhur, për shembull nuk keni marrë pjesë
2 vetë në takimin me njësitin Lumi dhe njësitin Çeliku se nuk
3 ishte në nivelin tuaj që të merrnit pjesë në këto takime. A
4 është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. E saktë. S'kam marrë pjesë.

6 PY. E kuptoj që tani ju jeni një biznesmen i suksesshëm,
7 megjithatë 25 vite më përpara, sikurse e keni përshkruar veten
8 tuaj në atë kohë, kur keni qenë pjesëtar i UÇK-së, ju sipas
9 asaj që keni thënë vetë me gojën tuaj, keni qenë thjesht një
10 ushtar i thjeshtë, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Saktë, edhe ashtu ka qenë.

12 PY. Pas këtij takimi, për të cilin ju tregoi videon
13 Prokuroria, pas takimit ku keni qenë i pranishëm, nuk e di në
14 qoftë se ju kujtohet ky fragmenti që dërgoi Prokuroria, ju
15 kujtohet, Dëshmitar?

16 PË. Po m'u ka rifresku kur e kam pa, dhe ishte një ndër
17 befasitë e mia që i vetmi dokument i luftës ishte ai që për
18 arsye se në luftë m'u kanë djeg të gjitha. Më kujtohet.

19 PY. Kishte një transkript në anglisht lidhur me përmbajtjen e
20 atij takimi, domethënë çfarë është thënë në atë takim. Do t'ju
21 lexoj një pjesë të asaj që është biseduar në takim.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për procesverbal është P00838,
23 në faqen 2 të këtij dokumenti. Tek pjesa që flet për Fatmir
24 Limajn.

25 PY. Dhe ai thotë:

1 "Përmes vendimit të shtabit lokal, departamenti për
2 marrëdhëniet civile, administrative... ish-të burgosur
3 politikë, aktivist të njohur, patriot, që vjen nga një
4 familje... pra një person i tillë caktohet në këtë
5 departament..."

6 Një person i tillë, pra, ky përshkrim a përkon me dikënd
7 si Gani Krasniqi, Dëshmitar? Si mendoni ju?

8 PË. Po, fjala është për Gani Krasniqin.

9 PY. E keni dëgjuar teksa unë po e lexoja, apo jo, që në fakt,
10 Gani Krasniqi ishte emëruar përmes vendimit të shtabit lokal,
11 për të drejtuar departamentin ose drejtorinë për çështje
12 civile, administrative dhe publike. A është e saktë jo,
13 Dëshmitar?

14 PË. E saktë, edhe deri atëherë siç e kam thanë ekzistojshin
15 raporte jo të mira mes ushtarëve të njësitit Lumi dhe njësitit
16 Çeliku, dhe asnjherë s'ish fol për një nivel ma të lartë, por
17 vetëm kjo ishte një bashkëpunim mes dy njësiteve të asaj kohe.

18 PY. E kuptojmë. Megjithatë, unë dua që të flasim për rolin e
19 tij. Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së keni thënë që
20 pajtoheni me Prokurorin se Gani Krasniqi ishte bërë
21 përfaqësues politik për Malishevën, dhe sipas mendimit tim, ai
22 ishte caktuar si administrator dhe ky perceptim ishte i
23 gabuar.

24 A e shikoni tani pasi e lexova unë këtë seksion, këtë
25 pjesë, Dëshmitar?

1 PË. Po, ishte caktuar si autoritet civil për problemet që u
2 shfaqshin në atë kohë në Malishevë.

3 PY. Faleminderit. Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së
4 Prokurori ju pyet, në qoftë se Gani Krasniqi është emëruar nga
5 Shtabi i Përgjithshëm.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca për procesverbal
7 është P01694.4 deri në 5 -- jo, faqet janë 4 deri në 5.

8 PY. Dhe kur ju janë, kur ju është bërë kjo pyetje, ju keni
9 dhënë këtë përgjigje:

10 "Këto lloj pyetjesh kanë të bëjnë më tepër me persona që
11 kanë qenë në një hierarki më të lartë. Unë vetë kam qenë një
12 ushtar i thjeshtë dhe nuk e di këtë gjë."

13 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po. Kam thanë që s'e di, se s'është kanë punë e imja ajo.

15 PY. A do kisha të drejtë unë që ju kam kuptuar në mënyrë të
16 tillë që ju thjesht po tregoheshit i singertë që mund ta
17 ndihmonit Prokurorinë dhe Trupin Gjykes për çështje të cilat
18 kishin të bënin me ju, me rolin tuaj si ushtar i thjeshtë, a
19 është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Saktë.

21 PY. Dhe në fakt, këto janë pyetje të cilat i duhen bërë
22 personave që kanë funksionuar në një nivel më të lartë sesa
23 ju, apo jo? Është e saktë kjo?

24 PË. Po, saktë.

25 PY. A pajtoheni me mua që arsyeja për këtë është se mbase në

1 qoftë se jepni ndonjë përgjigje, mund t'i thoni gjërat mbase
2 gabim, sepse ju nuk i keni parë me sytë tuaj, nuk keni qenë
3 përgjegjës vetë për gjëra të tilla, kështu?

4 PË. Po... po, mund të jetë kjo, por mund ta spjegoj kur e kam
5 llogarit hierarkinë në fjalën time.

6 PY. Jo, vetëm thjesht përgjigjuni pyetjeve të mia. Thjesht
7 përgjigjuni pyetjeve që po ju bëj, ju lutem. Pra, ju jeni
8 pozicionuar më mirë që të jepni përgjigje gjërave për të cilat
9 keni vetë ju njohuri, apo jo? Është e saktë kjo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Në fakt, besoj se i keni thënë ZPS-së kur ju ka
12 intervistuar, dhe referenca për këtë është P01694.6 [Sipas
13 përkthimit], faqen 3, që nuk e keni kuptuar në atë kohë që ju
14 si pjesëtar i UÇK-së nuk e dinit fare që kishte një Shtab të
15 Përgjithshëm që e udhëhiqte UÇK-në. A e kujtoni që ta keni
16 thënë këtë, Dëshmitar?

17 PË. E kam thanë, edhe s'kam dit për një shtab të tillë në atë
18 kohë.

19 PY. Faleminderit. Jeni larguar nga Kosova, jeni larguar dhe
20 nga UÇK-ja, me 20 shtator të vitit 1998 dhe keni ikur në
21 drejtim të Sllovenisë, kështu, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Kur jeni kthyer në Kosovë, në korrik të 1999?

24 PË. Në korrik -- po.

25 PY. E mbani mend datën?

1 PË. Kujtoj 2 korrik.

2 PY. Faleminderit. I keni thënë ZPS-së përpara një jave, dhe
3 referenca këtu është Shënimi përgatitor 1, paragrafi 27, që ju
4 nuk kishit asnjë informacion lidhur me atë se çfarë po bënte
5 UÇK-ja, ose çfarë ka bërë UÇK-ja pasi jeni larguar për
6 Slloveni në shtator të 1998. Dhe se nuk kishte asnjë
7 organizatë në Slloveni që e mbështeste këtë organizatën
8 "Vendlindja Thërret", dhe për këtë arsye, domethënë, nuk
9 kishit informacion, domethënë nuk dinit se çfarë kishte
10 ndodhur. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Saktë.

12 PY. A pajtoheni me mua, Dëshmitar, se çdo gjë që iu keni
13 thënë Prokurorit, pra Zyrës së Prokurorisë, lidhur me UÇK-në
14 dhe ngjarjeve në Kosovë pasi jeni larguar ju nga Kosova në
15 shtator të 1998-s janë gjëra të cilat i keni mësuar nga
16 persona të tjerë?

17 PË. Saktë.

18 PY. Një prej fushave që ju ka pyetur Prokurori në intervistën
19 përpara një jave, dhe që ju pyeti po ashtu sot, kishte të
20 bënte me identifikimin dhe keqtrajtimin, përfshirë këtu dhe
21 vrasjen e të ashtuquajturve kolaboracionistë.

22 PË. Po, pyetja e Prokurorit, po.

23 PY. Çfarëdo lloj gjëje që mund t'u ketë ndodhur këtyre
24 personave për të cilat ju pyeteni, domethënë, Jakup Kastratit,
25 Cen Deskut, Ramiz Hoxhës, Selim Binishit, Fetah Rudit, i ka

1 ndodhur, pra, të gjithë këtyre personave mund t'u ketë ndodhur
2 gjëra në kohën kur ju nuk keni qenë më pjesë e UÇK-së, a është
3 e saktë kjo?

4 PË. Saktë.

5 PY. Dhe disa prej tyre, në qoftë se jo të gjithë, të gjitha
6 këto gjëra kanë ndodhur ndërkohë që ju nuk keni qenë fare
7 brenda vendit, brenda Kosovës. A është e saktë kjo?

8 PË. E saktë.

9 PY. Ju keni dëgjuar lidhur me të gjitha këto ngjarje nga
10 persona të tjerë, ju vetë personalisht nuk e dini në qoftë se
11 çfarë ju kanë thënë këta persona të tjerë është e vërtetë apo
12 jo?

13 PË. Edhe në përgjigjen Prokurorit, jam deklaruar që aty janë
14 gjana që i kam dëgjuar nga të tjerët.

15 PY. Faleminderit. Për shembull, sa për ilustrim, Fetah Rudi,
16 i keni thënë Trupit Gjykues, ju ka thënë juve, personalisht,
17 që atë e kanë marrë sepse ishte përkrahës i LDK-së dhe i
18 Rugovës. A e keni dëgjuar po ashtu që ai është marrë sepse ka
19 qenë i përfshirë në një debat, një telash që kishte të bënte
20 me ndihmë humanitare, këtë e keni dëgjuar, Dëshmitar?

21 PË. Po unë kam tregu versionin e Fetahit, ça më ka thanë. Po,
22 edhe kjo flitet, se thashë edhe këtu, që ka qenë një
23 mosmarrëveshje rreth asaj ngjarjes së shpërndarjes së ndihma.

24 PY. Keni treguar versionin e Fetahut. Ju vetë personalisht
25 nuk e dini në qoftë se versioni që të ka thënë Fetahu është i

1 vërtetë, apo jo?

2 PË. Jo, s'e di atë.

3 PY. I keni thënë Prokurorisë, dhe për këtë referenca është --
4 atëherë, para se sa të vazhdojmë me pyetjen, kjo është e
5 vërtetë për të gjitha versionet që keni dëgjuar, apo jo? Ju
6 nuk keni nga e dini në qoftë se këto versione janë të sakta
7 tërësisht, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Jo, s'e kam konfirmu. S'mund t'i konfirmoj a janë të
9 sakta, vetëm kam tregu burimin e informacionit. Në këtë rast,
10 Fetahi.

11 PY. I keni thënë Prokurorisë dhe referenca për këtë është
12 P01694.8, pjesa 4, që ju e dini që ka pasur njerëz që kanë
13 bërë gabime në UÇK, "Por unë besoj që nuk është se ka pasur
14 ndonjë skenar të tillë, thjesht ka pasur persona që kanë qenë
15 të papërgjegjshëm që kanë tejkaluar kompetencat e tyre, dhe që
16 janë sjellë keq në raport me civilët..."

17 Çfarë keni dashur të thoni kur thoni që ka pasur persona
18 që i kanë tejkaluar kompetencat ose autoritetin e tyre,
19 Dëshmitar? Mund të na e shpjegoni?

20 PË. Në kuptimin e mosfrigimit kah ndëshkimi me ligj, për
21 arsye se s'ka funksionu pushteti ligjor në atë kohë.

22 PY. A pajtoheni me mua që këta persona nuk kanë vepruar nën
23 emrin e UÇK-së kur kanë bërë gjëra të tilla?

24 PË. Po, pajtohem, edhe ashtu ka ngja.

25 PY. Këta kanë qenë persona të cilët kanë keqpërdorur

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 91

1 uniformat e UÇK-së, apo jo?

2 PË. Po, derisa kemi qenë vullnetarë, edhe s'i kemi dhanë
3 llogari askujt për veprimet tona.

4 PY. A pajtoheni me mua se këta persona mund të kenë larë
5 hesapet personale për probleme që mund të kenë pasur në të
6 ardhmen [Sipas përkthimit]?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, kërkon spekulime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranojmë.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. Do ju referoj atëherë tek intervista, intervista është
11 SPOE -- ose është prova që është e pranuar tanimë, P01694.1,
12 faqen 14. Rreshtat 13 deri në 14. Prokurori ju ka pyetur, kur
13 keni qenë me policinë ushtarake juve ju kanë thënë [Sipas
14 përkthimit] në ZPS që, pra jeni këshilluar që të mos bëjnë, i
15 keni këshilluar të tjerët që të mos bëjnë gabime, dhe pyetja
16 që ju bën Prokuroria është kjo:

17 "Çfarë lloj gabimesh për çfarë lloj gabimesh e keni
18 fjalën? Për çfarë e keni këshilluar?

19 Dhe përgjigjja juaj është kjo:

20 "Në atë kohë kishte shumë probleme me njerëzit sa i takon
21 jo vetëm gjetjes së një arme, por gjithashtu edhe marrjes së,
22 larjes së hesapeve personale për arsye të ndryshme.

23 Më pas vazhdon pyetja, pra:

24 "PY. Pra, kjo ka qenë një prej shqetësimeve tuaja që të
25 edukonit ushtarët lidhur me përdorimin e armëve dhe lidhur me

1 mosmarrjen e, moslarjen e hesapeve personale?"

2 A ju kujtohet që ta keni thënë këtë më herët në përgjigje
3 të pyetjeve të Prokurorisë, Dëshmitar?

4 PË. Po, më kujtohet. Edhe roli jonë ka qenë i tillë,
5 këshillues, në atë kohë.

6 PY. Pra, njerëzit që merrnin hak ose lanin problemet e tyre
7 personale, ka qenë një shqetësim për juve, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Saktë, për arsye se ne si popull në atë kohë kemi pas
9 shumë ngatërresa dhe kena dyshu që dikush mund të hakmerret
10 për larje hesapesh.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund ta përsëris dhe një herë
13 pyetjen?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. A është e mundur që në qoftë se të ashtuquajtura gjëra të
17 këqija u ndodhnin atyre që quheshin kolaboracionistë, a është
18 e mundur që kjo mund të ketë ndodhur për arsye personale?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, kërkon spekulim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

21 Tani mund të largoheni, Dëshmitar, në qoftë se nuk keni
22 ndonjë pyetje, do bëjmë pushimin e drekës tani për rreth 30 --
23 1 orë e 30 minuta. Keni ndonjë pyetje, ose ndonjë gjë?

24 Përndryshe mund të largoheni.

25 DËSHMITARI: Pyetje, e kam një pyetje, kështu.

1 I nderuar --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta
3 bësh pyetjen.

4 DËSHMITARI: I nderuar Trup Gjykses, kam dëshirën që një
5 prej -- koha të ndahet edhe të them fjalën time edhe për këtë
6 proces. E në veçanti të them fjalën time për trajtimin tim
7 këtu. Kam një ankesë, edhe këtë unë kisha kërku njëherë prej
8 kohës të ma ndani që ta paraqes shqetësimin tim për zhvillimet
9 këtu.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 Do përfundojmë me pyetjet së pari, pastaj do ju caktojmë një
12 kohë.

13 DËSHMITARI: Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të dilni
15 nga salla tani.

16 DËSHMITARI: Faleminderit.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
19 pushim deri në orën 14.30.

20 --- Pauza fillon në orën 13.04

21 --- Seanca rifillon në orën 14.31

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kishit diçka
23 për të thënë?

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Me sa kuptoj unë, përgjigja që
25 do t'i japim ne parashtrimin të fundit të Prokurorisë për

1 deklarata të rregullës 154 e ka afatin më 1 tetor dhe sa u
2 takon përlllogaritjeve për pyetjet e kundërshtimeve përkatëse,
3 ne këto mund t'i dorëzojmë deri në datën 4 tetor.

4 Ne folëm me kolegun e Prokurorisë dhe thanë që nuk ka
5 problem për ata, në qoftë se të dyja kërkesat që kemi ne t'i
6 dorëzojmë në një datë që është përkatësisht data 4 tetor për
7 ne.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,
9 Prokuroria?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Z. ROWAN: [Përkthim] Edhe do bëjmë një kërkesë të
13 ngjashme në fund të ditës. Mbrojtja ka dy përgjigje të cilat
14 po i pret. Një është për një kërkesë të rregullës 155 edhe një
15 tjetër është kërkesë sipas rregullës 153, numrat përkatës të
16 parashtrimeve tona të protokolluara janë me numër 2599, 2601.
17 Të dyja duhen dorëzuar brenda 7 tetorit. Prokuroria tha që nuk
18 ka problem që ne përgjigjet t'i dorëzojmë brenda 18 tetorit.
19 Do i luteshim Trupit Gjykses të na miratonte këtë kërkesë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndikim tek
21 java e radhës e dëshmitarëve.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Konfirmoj pozicionin tonë që nuk
23 kemi asnjë problem në lidhje me këtë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
25 miratohet.

1 Tani mund të sillni dëshmitarin.

2 Edhe sa kohë do ju nevojitet.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe nja dhjetë minuta, besoj.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
6 Dëshmitar, do vazhdojmë tani. Mbrojtja e Thaçit ka ende disa
7 pyetje për ju, dëgjojeni me vëmendje.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

9 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Kur ju intervistoi Prokuroria gjatë
10 asaj kohe ju ka treguar dhe një dokument, dhe për procesverbal
11 bëhet fjalë për dokumentin me numër 1D0006. Ka qenë një vendim
12 ky i datës 10 korrik 1998 që mendohet se është nënshkruar prej
13 Gani Krasniqit. Dhe thoshte që të gjitha partitë politike, të
14 gjitha organizatat, duhen të lirojnë zyrat në katin e tretë.
15 Të kujtohet ky dokumenti? - e katërt, më falni.

16 PË. Po.

17 PY. Gjatë intervistës, Prokuroria ju ka pyetur disa herë nëse
18 sipas jush, ka qenë ky një urdhër për të mbyllur aktivitetet e
19 LDK-s, ju kujtohet kjo?

20 PË. Po. Pyetja ka qenë e tillë.

21 PY. Ti në çdo rast që ju kanë pyetur - do jap dhe referencë;
22 bëhet fjalë për materialin P01694.2, faqet 18 dhe 10 - pra, ti
23 çdo herë je përgjigjur dhe ke thënë, jo, urdhri nuk ka qenë
24 për të mbyllur veprimtarinë e LDK-së, të kujtohet?

25 PË. Saktë.

1 PY. Dhe po ashtu ke thënë se nga mënyra si ç'ke kuptuar ti
2 bëhej fjalë për hapësirë zyresh dhe i duhej UÇK-së ajo
3 hapësirë, prandaj iu kërkua partive politike që të lironin
4 zyrat, kështu?

5 PË. Po, për arsye se ishte një objekt shoqëror.

6 PY. Dhe ju keni thënë - po ja edhe referencën, në provën
7 P01694.4, faqja 23 - ju thatë që ju e keni menduar kështu,
8 sepse në vendimin dhe veprimet e mëpasshme në të vërtetë "LDK-
9 ja nuk e ndërpreu veprimtarinë, thjesht kaloi në një objekt
10 tjetër."

11 "Nëse do kishin pasur ata synim të ndërprisnin
12 aktivitetin, atëherë s'do t'i kishin lënë ata të vijonin në
13 një objekt tjetër privat."

14 PË. Saktë. Ata vazhduan në një objekt tjetër.

15 PY. I qëndroni ende kësaj?

16 PË. Po.

17 PY. Pra, urdhri s'ka qenë për të mbyllur veprimtarinë e
18 aktivitetit -- ndërprerë veprimtarinë LDK-së, kështu?

19 PË. Saktë. Ka qenë vetëm për lirim zyresh.

20 PY. Tani ne, unë e di që ju nuk keni anëtar i LDK-së, por
21 familjarët tuaj, bashkëfshatarët kanë qenë të gjithë përkrahës
22 të LDK-së dhe i përkrahin sot e kësaj dite, apo jo?

23 PË. Saktë. Përjashtim meje.

24 PY. Domethënë, mund ta themi kështu: Të ishte anëtar i LDK-së
25 dhe i UÇK-së njëkohësisht nuk ishte ndonjë problem?

1 PË. 90 për qind të ushtarëve të UÇK-së kanë qenë të tillë.

2 PY. Nuk duhej të hiqje dorë nga anëtarësia e LDK-së që të
3 kyçeshe në UÇK, apo jo?

4 PË. Jo, s' ishte kusht.

5 PY. I keni thënë Prokurorisë këtu, pra, në materialin
6 P01694.7, në faqen 1, ju keni thënë se synimi i UÇK-së ishte
7 të fitonte pavarësinë prej serbëve?

8 PË. Korrekt, saktë.

9 PY. Po LDK-ja, a ndante të njëjtin objektiv?

10 PË. Të njëjtin objektiv e ndajkin, e njëjtë edhe LDK-ja dhe
11 aty ai që ishte për -- besojke në atë kohë në çështje paqësore
12 të cilën nuk u zgjidh asnjëherë.

13 PY. Letrën ia ke çuar ti shokun tënd Jakup Kastratit, apo jo?

14 PË. Mikun tim dhe mësuesit tim, po, unë personalisht.

15 PY. I keni thënë ZPS-së - në provën materiale P01694.2 në
16 faqen 22 - ju thatë që Jakup Hoti nuk mund të urdhëronte ty ta
17 dorëzoje, ndonëse ishte eprori juaj?

18 PË. Jo, urdhër s' mund të jepte.

19 PY. Po pse jo?

20 PË. Për arsye se ishim vullnetarë të dy.

21 PY. Ju bënë një pyetje ju: Nëse ju personalisht apo Jakup
22 Hoti do të refuzonit ta ekzekutonit, pra, zbatonit vendimin, a
23 do të ndëshkoheshit apo qortoheshit. Dhe ju i keni thënë ZPS-
24 së që, "Jo se ne ishim të gjithë vullnetarë. Unë vullnetarisht
25 u kyça edhe vullnetarisht mund të largohesha të kthehesha në

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 98

1 shtëpi", kështu?

2 PË. Saktë, kështu qëndron.

3 PY. Domethënë, askush nuk mund të detyronte ty që të kyçeshe
4 në UÇK, apo jo?

5 PË. Jo.

6 PY. As nuk mund t'ju thoshte dikush mos u largoni?

7 PË. Absolut jo.

8 PY. Dhe askush nuk mund të detyronte të bëje diçka, përshirë
9 këtu edhe zbatimin e një urdhri që vinte nga eprorët?

10 PË. Saktë, s'ka mundur askush të detyrojë diçka pa vullnetin
11 tënd.

12 PY. Faleminderit, nuk kam më pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Dixon, fjala është për ju.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Zotëri, unë quhem Rodney Dixon. Përfaqësoj z. Kadri

19 Veseli. Dhe unë do t'ju bëj disa pyetje tani.

20 Ju na shpjeguat se jeni bërë anëtar i policisë ushtarake
21 në mes të qershorit 1998. Kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Ju keni thënë po ashtu se deri nga mezi i korrikut '98,
24 ka qenë një, pra, Malisheva ka qenë konsiderohej një lloj,
25 mund të themi një lloj zone e lirë, kështu?

1 PË. Kështu e kemi quajt, po.

2 PY. Ju e quanit ashtu sepse atje nuk kishte forca serbe në
3 atë zonë.

4 PË. Po.

5 PY. Nuk kishte policë serbë në atë periudhë.

6 PË. Saktë.

7 PY. Dhe po flasim për një periudhë relativisht të shkurtë, ë,
8 vetëm një muaj nga mesi i qershorit kur u kyçe në policinë
9 ushtarake deri nga mesi i korrikut 1998, kaq ka qenë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Në njësinë tuaj, a kishte tre persona gjithsej në njësinë
12 tuaj, për policinë ushtarake po flasim?

13 PË. Po, vetëm tre ishim në atë kohë.

14 PY. Në atë periudhë kohore, atë një muaj, ju keni thënë se si
15 jeni përpjekur të organizoheshit, të organizonit aktivitete,
16 për shembull, ju treguan, nga ana e Prokurorisë ju tregoi disa
17 fletëlëshime sot paradite, të kujtohen?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ti the se i keni krijuar këto procedura që të
20 krijonit një lloj rregulli e ta bënit më të vështirë për
21 anëtarët e UÇK-së që të shisnin në mënyrë të paligjshme armët
22 e tyre apo t'i nxirrnin publikisht në Malishevë, kështu?

23 PË. Më shumë kishte karakter që të mos i nxirrnim publikisht.

24 PY. Mos t'ua nxirrnin publikut dhe sidomos në treg, kështu?

25 PË. Saktë.

1 PY. Ju thatë gjithashtu se keni bërë një kërkesë që të
2 përfshinte numrat serial të armëve tek këto lejet,
3 fletëlëshimet, por në fakt në praktikë kjo nuk ndodhi
4 asnjëherë, kështu?

5 PË. Jo, s'ka ndodh.

6 PY. Domethënë në këto fletëlëshime nuk kishte detaje të
7 armëve, kështu?

8 PË. Jo, vetëm emrat e atyre që lëvizshnin.

9 PY. Ju keni dhënë dëshmi, dhe keni thënë se ajo që mund të
10 bënit ju ishte vetëm t'u jepnit këshilla ushtarëve të UÇK-s,
11 jo t'i urdhëronit, duke qenë se ishte një ushtri vullnetare,
12 kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Në intervistë ju thatë:

15 "Nuk mund të bënit më shumë me personat se ata kishin
16 armë, ne kishim armë, kështu që më shumë ishte një formë
17 këshillimi ajo që bënim ne."

18 Të kujtohet kjo?

19 PË. Po, ashtu e kam thënë dhe ashtu ishte.

20 PY. Domethënë ata s'kishin pse t'jua dëgjoni fjalën, apo jo?

21 PË. Jo se ishim në hierarki të njëjtë të ushtarëve [E
22 pakuptueshme] ata.

23 PY. Ju thatë që ishit i shqetësuar për këto larjet e hesapeve
24 kryesisht nga persona që kishin armë në UÇK, për shkak të
25 mosmarrëveshjeve të së shkuarës. Po ju ishit në gjendje të

1 ndërmerrnit ndonjë hap për t'i trajtuar këto shqetësime?

2 PË. Për -- luajshim rolin e ndërmjetësuesit që t'i pajtojmë
3 dhe t'i ulim gjakrat.

4 PY. Kur thatë -- kur thoni jeni, keni qenë ndërmjetësues ose
5 në rolin e ndërmjetësuesit, këtë e keni bërë për personat që
6 kishin inate të vjetra e që deshën të merrnin hak?

7 PË. Sigurisht, po.

8 PY. Dua t'ju tregoj një pjesë tjetër të atij blloku të
9 shënimeve që pamë sot paradite që u pranua si provë gjyqësore.
10 Ka disa faqe të këtij blloku që dua t'i shohim bashkë dhe të
11 na jepni dëshminë tuaj.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Do lutesha që të vendoset në ekran
13 materiali P01698. Faqja 7 e anglishtes, ju lutem. Është
14 raporti i datës 6 korrik 1998. Gjejmë dhe shqipen ndërkohë.
15 Faqja 10.

16 PY. Ky është një raport që është shkruar më 7 korrik 1998.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Na nevojitet -- po, kjo është faqja.

18 PY. Këtu është një pjesë që do t'jua lexoj, është paragrafi i
19 dytë, thotë:

20 "Gazmend Kryeziu nuk ka qenë në këtë turn. Në turnin e
21 tretë nga ora 13.00 deri në orën 20.00 ushtarët si në vijim
22 nuk kanë qenë të pranishëm: Sejdi Berisha (që u zëvendësua nga
23 Mehmet G. Gashi); Bashkim Gashi (këto të dy nuk kanë qenë te
24 pika numër 4); Bedri Krasniqi (nga pika numër dy) në shenjë
25 proteste pse ai ishte në detyrë në pikën e dytë dhe jo në

1 pikën e parë.”

2 E patë, e shikoni?

3 PË. Po.

4 PY. Të kujtohet ky rast?

5 PË. Jo, nuk ka kalu ky përmes neve, por u zgjidh brenda asaj
6 pikës ku kanë kujdestaru.

7 PY. Po a është ky një rast që tregon mosmarrëveshjet që
8 ekzistonin asaj kohe në fillim të korrikut 1998, kur një
9 person thjesht nuk vinte të kryente detyrën, është ky një
10 shembull që tregon që ndodhnin të tilla gjëra në atë kohë?

11 PË. Po, sigurisht.

12 PY. Po ju në policinë ushtarake mund të bënit ndonjë gjë në
13 lidhje me këtë?

14 PË. Jo, do të ishim shku dhe ta këshillonim që nuk t'u ka bo
15 padrejtësi dhe t'i kthehet rojës prapë.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Shohim faqen 8, ka një raport tjetër
17 që është i datës 9 korrik.

18 PY. Shikoni këtu që ka një shënim, ku thotë vërejtje:

19 “...rojat e fshatit nuk kanë ardhur në ndërrimin e turnit
20 prej orës 01.00 deri në orën 06.00 dhe personi që ishte
21 caktuar, Xhevdet Kryeziu thjesht nuk ka ardhur dhe nuk është
22 paraqitur.”

23 E shihni?

24 PË. Po. Pra, a pajtoheni me mua që ky është një rast tjetër
25 se si roja e fshatit thjesht vendoste të mos vinte për të

1 kryer detyrën?

2 PË. Po e thashë më herët se s'kanë qenë të detyruar. Ka qenë
3 një organizim vullnetar i caktuar që të bëjmë roje.

4 PY. Dhe ju në cilësinë tuaj si polic ushtarak s'mund të bënit
5 asgjë për t'i detyruar apo jo?

6 PË. Absolut jo.

7 PY. As nuk mund të ndërmerrnit masa disiplinore, apo jo?

8 PË. Jo s'kemi përdorur në asnjë rast, përveç atyne këshilluese.

9 PY. Në fakt keni thënë gjatë intervistës me ZPS-së - që është
10 në faqen 16, Pjesa 4 - ju thatë për të ruajtur rendin publik:

11 "Ishte pak për të qeshur se tre persona s'kanë se si ta
12 ruajnë rendin publik."

13 A ka qenë kështu?

14 PË. Kështu ka qenë.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull, mund të hiqet dokumenti
16 nga ekrani. Faleminderit.

17 PY. Dëshmitar, në këtë periudhë kohore, a është e vërtetë që
18 ju nuk kishit rregullore me shkrim që të rregullonte punën
19 tuaj si polici ushtarak dhe që ta zbatonit ju dita-ditës?

20 PË. Jo, nuk kishim.

21 PY. Bëhej kryesisht me gojë edhe si të lindte nevoja, kështu?

22 PË. Saktë. Brenda neve grupes prej tre vetëve.

23 PY. Tani do doja të flasim për fundin e këtij muaj kur nuk
24 ekzistoi më zona e lirë, si e tillë. Për këtë qëllim do doja
25 që të shihnim një hartë se do na ndihmojë që ta kuptojmë të

1 gjithë si ka qenë situata nga mezi i korrikut e në vijim.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Harta ka numrin DKV0007-0007.

3 PY. Dëshmitar, kjo është një hartë e Malishevës, e zonës së
4 Malishevës.

5 PË. Po.

6 PY. Bazuar në ato që i keni thënë ju Prokurorisë, dhe mund të
7 na thoni nëse e kemi kuptuar siç duhet, ne e dimi që ju nuk
8 keni marrë, ju personalisht nuk keni marrë pjesë në operacione
9 ushtarake të Rahovecit të cilat filluan më 17 korrik edhe
10 vazhduan për disa ditë, kështu?

11 PË. Kështu, saktë.

12 PY. Në atë kohë ke qenë në fshatin tënd të lindjes?

13 PË. Po. Ditën e parë kam qenë në Malishevë, ditë të tjera në
14 fshatin e lindjes.

15 PY. Bubël, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Na ndihmoni ju lutem, që të orientohemi. A mund të na
18 tregoni ku është Bublë në hartë? Do i lutesha, Asistentes së
19 Gjykatës të na ndihmojë me një shënjes që të bëni shënimin
20 përkatës në hartë.

21 PË. [Shënon]

22 PY. Vendos dhe numrin 1 përbri, që ta kuptojmë nga ishit ju,
23 nga 18 korriku e në vijim.

24 PË. Saktë.

25 PY. Gjithashtu, ju lutem, shënoni dhe Malishevën. E dimë të

- 1 gjithë ku është, por për procedurë, ju lutem, shënojeni me 2-
2 sh.
- 3 PË. [Shënon]
- 4 PY. Rahovecin ku ndodhi dhe beteja, ju lutem, me 3-sh.
- 5 PË. [Shënon]
- 6 PY. Që ta kuptojmë qartë, Malisheva është dhe qytezë dhe
7 komunë, domethënë, është komunë?
- 8 PË. Po, komunë është.
- 9 PY. Me përparësi i shënon dot kufijtë e kësaj komune?
- 10 PË. Në hartë?
- 11 PY. Ju lutem, në hartë.
- 12 PË. Kryesisht këtu janë ato rrugë kryesore.
- 13 PY. Domethënë, kjo është pjesa e komunës së Malishevës, ë,
14 kjo me shënimet?
- 15 PË. Po.
- 16 PY. Në dëshminë tuaj keni thënë se më 17 korrik UÇK-ja ka
17 hyrë në Rahovec, por ju nuk keni qenë pjesë. Kështu?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Njësitë kryesore kanë qenë të asaj zone, pra, zona që i
20 takon ka qenë jashtë Malishevës?
- 21 PË. Jashtë Malishevës.
- 22 PY. Pra, që kanë hyrë më datë 17 kanë qenë jashtë asaj zone,
23 kështu?
- 24 PË. Po.
- 25 PY. Ju keni thënë gjithashtu, se nuk ka pas ndonjë planifikim

1 asokohe kur filloi ky operacion nga këto njësi; s'pati ndonjë
2 planifikim paraprik - paraprak, më falni - dhe ju thatë që ka
3 qenë një nga gabimet më të mëdha të UÇK-së. Të kujtohet?

4 PË. Po, për arsye se s'kishim dëgju për një gjë të tillë që
5 mund të ndodhë.

6 PY. Po, pse keni thënë kështu, pse keni thënë që ka qenë
7 gabimi më i madh?

8 PË. Po, gabimi më i madh për arsye se ishte popullata e
9 përzier aty, serbe dhe shqiptare dhe ishte vendi i urbanizuar
10 si qytet.

11 PY. Keni thënë që nuk ka pasur planifikim në atë kohë.
12 Njësiti juaj nuk ka qenë i përfshirë në atë operacion, apo jo,
13 Dëshmitar?

14 PË. Jo.

15 PY. Por pas asaj, pra, pas këtij operacioni fillestar disa
16 anëtarë të njësitet tuaj shkuan atje për të ndihmuar, a është
17 e saktë kjo?

18 PË. Po, e saktë, në mënyrë vullnetare ka lëvizur dhe kanë
19 shkuar.

20 PY. Ditën e dytë që i takon që është 18 e tani, dita tjetër,
21 dita e tretë që është 19 korriku, keni thënë që ka pasur një
22 sulm serb tjetër ndaj UÇK-së, dhe si rezultat i këtij sulmi në
23 ditët pasuese shumë civilë shqiptarë u larguan prej asaj zone
24 në drejtim të Malishevës, a është e saktë kjo?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Thatë që rreth 700, vetëm, pra, kjo ishte sasia e
2 personave, 700 veta erdhën në Bubël, në fshatin tuaj, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Pra, janë larguar nga Rahoveci dhe pastaj kanë ardhur në
5 pjesën jugveriore të fshatit tuaj, kështu?

6 PË. Po, duke ndier veten më të sigurt, sa më larg luftimeve
7 që ndodhshin.

8 PY. Në dëshminë tuaj keni thënë që në shtëpinë tuaj ju keni
9 mbajtur, keni strehuar 70 persona, a është e saktë kjo,
10 Dëshmitar?

11 PË. E saktë.

12 PY. Në këtë kohë, duke pasur parasysh rolin që keni luajtur
13 në UÇK, ju keni thënë që përgjegjësia juaj ka qenë që të
14 kujdeseshit për këta persona që të gjendeshit vende për ta për
15 t'u strehuar dhe ushqim për të ngrënë, a është e saktë kjo?

16 PË. Sigurisht se me ta kishim lidhje miqësore të mëhershme.

17 PY. Në ditët pasuese, domethënë, pas datës 19, a është e
18 saktë që forcat serbe i kanë ndjekur civilët nga zona e
19 Rahovecit dhe kanë ardhur në drejtim të Malishevës, a ka qenë
20 kështu?

21 PË. Kështu ka qenë.

22 PY. A e dini se çfarë rrugësh kanë përdorur ata për të ardhur
23 në Malishevë?

24 PË. Në rrugën Rahovec-Malishevë.

25 PY. Kanë ardhur rrugës ata për aty?

1 PË. Po, po asaj rruge.

2 PY. Është e saktë, apo jo, që deri më datë 26 korrik

3 Malisheva ishte tejkaluar nga forcat serbe?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. A e dini se çfarë po ndodhte ndërkohë në zonat përreth?

6 Domethënë forcat serbe kanë lëvizur dhe në zona të tjera në

7 atë zonë apo kanë qenë vetëm në Malishevë? Domethënë, çfarë ka

8 ndodhur në zonat përreth?

9 PË. Kanë lëviz edhe nga drejtimi i Drenasit, Gllogovac [E
10 pakuptueshme] e kem edhe nga drejtimi i Duhlës.

11 PY. A mund të na caktoni këtu në hartë në mënyrë të tillë që
12 mund të dimë se ku janë këto zona konkretisht? Thjesht caktoni
13 një numër për secilin prej tyre. Domethënë, caktoni numrin 4.

14 PË. A numër, po. A 4 me vazhdu?

15 PY. Po.

16 PË. [Shënon]

17 PY. Edhe këtë vendin tjetër që përmendët, këtë caktojani me
18 numrin 5.

19 PË. 5 [Shënon]

20 PY. Është e saktë të thuhet, apo jo, Dëshmitar, që gjatë saj
21 periudhe, domethënë, gjatë gjysmës së dytë të korrikut deri në
22 fund të korrikut, e gjitha zona ishte e marrë në dorë të
23 forcave serbe?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. UÇK-ja në atë zonë ishte shpërbërë, apo jo?

1 PË. Ishte po, ishte ndarë në grupe shumë të vogla dhe ishin
2 shpërndarë pyjeve.

3 PY. Ju dhe persona të tjerë në atë zonë, domethënë, që ju
4 kryesisht ishit të zënë për t'u kujdesur për këta persona që
5 kishin ardhur në zonën tuaj. Ju kryesisht bënit këtë punë, apo
6 jo, Dëshmitar?

7 PË. Po, edhe na u desht edhe neve atëherë të lëshojmë fshatin
8 dhe të ngjitem malit edhe me ata mysafirët që i kishim.

9 PY. A mund të na thoni se në çfarë malesh, domethënë, na
10 tregoni këtu në hartë në çfarë zone, në çfarë malesh u
11 tërhoqët ju në mal, në afërsi të fshatit tuaj?

12 PË. Me i shënu numër?

13 PY. Po, tani kemi shënuar deri në 6. Kështu që vazhdoni nga 7
14 e sipër.

15 PË. [Shënon]

16 PY. Në atë kohë civilët ishin të traumatizuar dhe kishin
17 shumë frikë lidhur me atë se çfarë mund t'ju ndodhte, apo jo,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, saktë, se u kap -- ushtria dhe policia serbe duke
20 përshirë edhe paramilitarët ku hyjshin në fshat i kallshin
21 shtëpitë e banorëve.

22 PY. Në këtë kohë nuk kishte asnjë vend të sigurt për civilët
23 shqiptarë, apo jo?

24 PË. Jo, të vetmet ishin pyjet.

25 PY. Dhe ju jeni fshehur pikërisht në këto vende, domethënë në

1 pyje, kështu?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Ne e dimë nga dëshmia e mëparshme e juaj se jeni larguar
4 nga UÇK-ja në shtator, domethënë, në pak kohë pas kësaj
5 ngjarje. Sepse keni thënë që UÇK-ja ishte shpërbërë si
6 organizatë, është e saktë kjo?

7 PË. E saktë ishte për atë periudhë.

8 PY. Dhe pastaj u larguat fare nga Kosova pas këtyre
9 ngjarjeve. U larguat nga Kosova dhe shkuat në Slloveni, e
10 saktë?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Megjithatë deri në atë kohë ju keni qenë në terren. Pra,
13 keni qenë në atë zonë në terren, i keni parë me sytë tuaj se
14 çfarë ka ndodhur, apo jo?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe do i kërkoja Sekretarisë të paraqesë dy dokumente që
17 janë raporte ndërkombëtare --

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A doni që ta ruani këtë
19 hartë?

20 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit shumë se do na humbte
21 harta. Do kërkoja që të ruhet harta bashkë me shënimet dhe të
22 pranohet si provë gjyqësore.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] Dokumenti DKV0007 deri në 0007 dhe që është
2 hartë, pranohet si provë.

3 Ju lutemi caktojini një numër prove.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 harta bashkë me shënimin do të marrë numrin e provës 2D31. Si
6 do klasifikohet?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Konfidenciale
8 apo publike?

9 Z. DIXON: [Përkthim] Do klasifikohet si konfidenciale.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Z. DIXON: [Përkthim]

12 PY. Dëshiroj të tregoj dy dokumente të tjera që kanë të bëjnë
13 me këtë periudhë.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Dokumenti i parë është një dokument
15 që është pranuar në provë gjyqësore që ka numrin e provës
16 2D0004. Është një pjesë e një raporti të Kolonelit John
17 Crosland, atashe britanik në Beograd. Ky është raport i cili
18 është vetëm në anglisht në fakt.

19 PY. Dëshmitar, raporti është vetëm në anglisht, megjithatë do
20 t'ju lexoj pjesën përkatëse. Mund ta dëgjoni nga përkthimi dhe
21 pastaj do t'ju bëj pyetje lidhur me të.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Është një pjesë që fillon nga faqja
23 2, dhe paragrafi që shënohet me dy.

24 PY. Është raporti i cili mban datën 5, 6 gusht 1998. Aty
25 thuhet, do t'jua lexoj dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje

1 lidhur me të. Atëherë:

2 "CIVPOP," që është popullsia civile, "e shkatërruar. Në
3 të gjithë zonën ka shumë pak popullsi civile që mund të
4 shihen. Shikon një varg humanitar që del në veri nga
5 Malisheva. Malisheva tani është tërësisht e zaptuar nga
6 plaçkitjet dhe është në flakë."

7 Ky është një përshkrim nga fillimi i gushtit të vitit
8 1998. A përkon ky përshkrim me atë çfarë keni parë ju me sytë
9 tuaj në Malishevë në atë kohë dhe ajo çfarë keni dëgjuar
10 lidhur me Malishevën në atë kohë?

11 PË. Po, kjo është e saktë.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekрани.

14 Dokumenti i fundit që nuk është provë, kështu që do më
15 duhet t'ju jap numrin SITE. Është dokumenti SPOE00304290.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë doni të
17 thoni, Dëshmitar?

18 DËSHMITARI: Më vjen, ka bisedon avokati, më vjen zëri i
19 tij i zmadhuar, volumi shumë i madh në gjuhën angleze. Më
20 herët s'e dëgjojsha kështu, tash.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do shohim se
22 mos e rregullojmë. Po tani, është më mirë, dëgjon më mirë?

23 DËSHMITARI: Mirë, më mirë është, po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 vazhdoni, z. Dixon.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

2 Z. DIXON: [Përkthim]

3 PY. Edhe një herë, ky është një dokument i cili është i
4 disponueshëm në anglisht, jo në shqip. Kështu që do lexoj dy
5 pjesë të shkurtra të tij dhe pastaj do ju pyes që të bëni dy
6 komente, disa komente lidhur me to. Atëherë së pari do
7 fillojmë te kjo pjesa "Situata ushtarake." Është një raport
8 nga Shtabi i Monitorimit Evropian dhe në të jepet një
9 përmbledhje e situatës ushtarake me datë 23 shtator 1998.
10 Është raportim për javët e mëpërparshme:

11 "Që prej kur kanë filluar ofensivat të forcave të
12 sigurimit dhe armatës jugosllave në fund të korrikut ata kanë
13 rifituar në mënyrë të suksesshme pjesën kryesore të territorit
14 që ka qenë në kontrollin e UÇK-së, kryesisht në zonën në
15 Malishevë, në Deçan, Junik dhe një pjesë të konsiderueshme të
16 Drenicës dhe të Shalës."

17 Tani mbajeni mend këtë që sapo thashë dhe ndërkohë do të
18 vazhdoj dhe do të lexoj një tjetër pjesë që tregon se "Çfarë i
19 ka ndodhur UÇK-së në atë kohë."

20 "UÇK-ja duket sikur është shpërbërë. Infrastruktura e
21 UÇK-së, megjithëse nuk ka qenë asnjëherë e sofistikuar, është
22 ndërprerë në mënyrë të suksesshme dhe UÇK-ja është zvogëluar
23 në xhepa në grupe shumë të vogla dhe është shpërndarë në të
24 gjithë vendin."

25 Pra, ju lexova dy pjesë të këtij raporti, Dëshmitar, që

1 është raport i 23 shtatorit 1998 në kohën që ju jeni larguar
2 prej Kosove. Pra, janë dy pjesë të cilat i referohen
3 vlerësimit të situatës përpara shtatorit dhe thuhet që UÇK-ja
4 duket sikur është shpërbërë. A është ky një përshkrim i saktë
5 i situatës në terren, Dëshmitar?

6 PË. Unë mendoj po dhe përkon 100 për qind me përshkrimin tim
7 dhënë pranë Prokurorisë se kështu ka qenë.

8 PY. Ku thuhet që infrastruktura është ndërprerë në mënyrë të
9 suksesshme dhe UÇK-ja është zvogëluar në grupe të vogla ose në
10 xhepa të vogla, a përkon kjo me mënyrën se si ju kujtohet ju
11 situata në atë periudhë në korrik, gusht dhe shtator të atij
12 viti?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
17 z. Dixon.

18 Z. Roberts.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje për këtë dëshmitar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. V. Alagendra, pyetje prej jush?

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
23 Gjykatës.

24 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

1 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

2 PË. Mirëdita.

3 PY. Unë jam znj. Alagendra, dhe jam përfaqësuese e Jakup
4 Krasniqit, jam avokatja e tij. Dëshmitar, do flasim lidhur me
5 atë çfarë i keni thënë Prokurorisë në dëshminë në vitin 2019
6 sa i takon takimit në Malishevë rreth fundit të qershorit,
7 fillimit të korrikut '98-s. A ju kujtohet ta keni diskutuar
8 këtë temë me Prokurorinë në vitin 2019, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. A ju kujtohet që e keni diskutuar këtë temë me
11 Prokurorinë edhe përpara një javë ku keni bërë ca sqarime dhe
12 shtesa të tjera?

13 PË. Po - më falni - po.

14 PY. Ky takim është bërë në një restorant që quhet Reforma,
15 apo jo, është e saktë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Ju kujtohet që në atë kohë ka pasur gazetarë dhe juve ju
18 është thënë që gazetarët kanë qenë brenda takimit, a është e
19 saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Ju vetë personalisht nuk keni qenë pjesë e atij takimi,
22 apo jo Dëshmitar?

23 PË. Jo.

24 PY. Keni qenë disa metra jashtë restorantit.

25 Jakup Hoti, po ashtu ka qenë jashtë vendit ku është

1 organizuar takimi. Ai ka qenë bashkë me ty, është e saktë kjo?

2 PË. Jo, Tahir Ulluri ka qenë me mua, Jakupi jo.

3 PY. Ky është takimi i parë në vendin me emrin Reforma, në
4 mënyrë të tillë që ta kemi të qartë se për çfarë po
5 diskutojmë. Bëhet fjalë për takimin e parë, në rregull,
6 Dëshmitar?

7 PË. Korrekt.

8 PY. I keni thënë Prokurorisë se disa metra në distancë ku
9 keni qenë, ju keni parë që njerëzit kanë mbërritur në
10 restorant dhe janë futur brenda në restorant. A ju kujtohet
11 kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Personat që keni njohur kanë qenë Gani Krasniqi, Isni
14 Kilaj, Haxhi Shalaj, Fatmir Limaj, Musë Jashari dhe Skënder
15 Krasniqi, a është e saktë kjo?

16 PË. Po, ata që i kam njoft, me përjashtim Musë Jasharin s'e
17 kam njoftë, po mbasandej më kanë thënë se ka qenë ai.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë të
19 paraqesë në ekran dokumentin DHK00239.

20 PY. Dëshmitar, kjo është një fotografi e marrë nga një video
21 e *Associated Press*. A konfirmoi që kjo është fotografia e
22 Skënder Krasniqit, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani

1 fotografinë.

2 Të nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se është e mundur
3 që ta pranojmë si provë këtë fotografi.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
5 kundërshtime?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
8 DJK00239 pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i
10 caktohet numri i provës 4D84. Do i lutesha Avokates të
11 konfirmojë klasifikimin.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Klasifikohet si publik
13 apo konfidencial?

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të klasifikohet si
15 publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
17 kundërshtim për këtë klasifikim?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY Pra, Dëshmitar, ju nuk e keni parë z. Jakup Krasniqi që
21 të futej në atë vend për takim, kështu?

22 PË. Nuk e kam parë; s'ka qenë.

23 PY. Përpara një jave i keni thënë Prokurorisë - dhe për
24 procesverbal kjo jepet në Shënimin Përgatitor numër 1,
25 paragrafi 9 dhe 10 është prova e pranuar P1695 - pasi e patë

1 atë që të hynte, Jakup Hoti, ti bashkë me të jeni larguar dhe
2 keni shkuar në një fshat tjetër dhe jeni kthyer pak a shumë
3 pas një orë pasi kishte përfunduar takimi, a është e saktë
4 kjo?

5 PË. E saktë.

6 PY. Domethënë, personi me të cilin keni qenë ju ka qenë Jakup
7 Hoti, apo jo?

8 PË. Këtu përdoren dy, takimi i parë ishte Tahiri me mua, kur
9 jam kthyer nga fshati ishte dhe Jakupi me ne. Domethënë më
10 vonë kjo ishte me Jakupin, po të njëjtën ditë.

11 PY. Dhe në të dyja rastet ju nuk e keni parë fare z. Krasniqi
12 aty, apo jo? Në atë takim z. Krasniqi s'e keni parë?

13 PË. Jo, jo në takime jo, jo.

14 PY. Ndërkohë që përfundoi takimi dhe kur persona që ishin të
15 pranishëm në takim po largoheshin, ju keni parë veturën e
16 Jakup Krasniqit në rrugë që po futej ose po mbërrinte në
17 Malishevë, a është e saktë kjo?

18 PË. Po, kjo ishte një orë më tepër, më vonë mbasi ka përfundu
19 takimi.

20 PY. Z. Krasniqi po futej në Malishevë në atë kohë, kështu apo
21 jo bashkë me veturën?

22 PË. Po.

23 PY. Z. Krasniqi kishte veshur rroba civile, nuk kishte
24 uniformë kur doli nga makina, por kishte kostum, ishte i
25 veshur me kostum? A është e saktë kjo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Ju e përshëndetët z. Krasniqi në atë pikë, po?

3 PË. Po, unë s'e njifsha, por Jakupi e njifte dhe unë e
4 shfrytëzova rastin ta përshëndes.

5 PY. Në deklaratën tuaj keni përmendur që Jakup Krasniqi është
6 nipi i Jakup Hotit. Pra, është e saktë kjo, apo jo?

7 PË. Po, po ashtu janë.

8 PY. Ata thjesht shkëmbyen ca -- nuk është se bënë asnjë
9 takim, vetëm thjesht u përshëndetën, shkëmbyen përshëndetje,
10 apo jo? Kaq ndodhi atë ditë?

11 PË. Po, po si nipi me dajën.

12 PY. Është e saktë apo jo, Dëshmitar, që kjo është hera e
13 vetme kur ju e keni parë z. Krasniqi, domethënë, Jakup
14 Krasniqin në Malishevë, apo jo?

15 PË. E vetmja, dhe ishte hera e parë që e shihja kështu nga
16 afër përveç asaj fotografisë nga televizioni.

17 PY. Në rregull. I vetmi rast tjetër kur ju besoni që Jakup
18 Krasniqi ka qenë në Malishevë është atëherë kur ju thoni që ka
19 pasur një darkë të shtruar në shtëpinë e axhës së Jakup Hotit,
20 a ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorit, Dëshmitar?

21 PË. Po, ashtu më ka thënë mua edhe kam qenë i ftuar, por unë
22 s'kam qenë prezent.

23 PY. Ju nuk keni qenë prezent aty në atë darkë, kështu që nuk
24 e dini në qoftë se z. Krasniqi ka qenë aty apo jo, kështu?

25 PË. Po, s'e di.

1 PY. Tani dua të kalojmë në një temë tjetër. Ka të bëjë lidhur
2 me atë çfarë ju ka thënë Jakup Kastrati ju.

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Për referencë bëhet fjalë
4 për provën P1694, faqja 6, faqja 13

5 PY. Ju keni thënë:

6 "Jakup Krasniqi ka akuzuar Cen Deskun dhe Jakup Kastratin
7 në gjykimin kundër Fatmir Limajt si bashkëpunëtorë ose
8 kolaboracionistë. Dhe për shkak të asaj që ka thënë -- atë
9 çfarë ka thënë ai unë nuk e kam ftuar atë asnjëherë që të jetë
10 mik në shtëpinë time, pavarësisht që ka qenë në shtëpinë time
11 si mik dhjetëra herë pas lufte. A ju kujtohet t'ia keni thënë
12 këtë Prokurorisë në 2019, Dëshmitar?

13 PË. Po, vetëm që e kam thënë që këto m'i ka thënë mësues
14 Jakup Kastrati, jo që e kam përcjellë unë direkt në
15 televizion.

16 PY. Ajo çfarë të tha ty Jakup Kastrati të kishte bërë pak të
17 hidhur me Jakup Krasniqin, apo jo? Domethënë kishte ndikuar
18 negativisht mbi ty lidhur me Jakup Krasniqin?

19 PË. E saktë.

20 PY. Përpara një javë, e sqaruat me Prokurorinë se ju nuk e
21 keni ndjekur gjykimin kundër Fatmir Limajt, por thjesht të
22 kanë thënë lidhur ose të kanë treguar lidhur me dëshminë e z.
23 Krasniqi dhe këtë ta ka treguar Jakup Kastrati, a është e
24 saktë kjo?

25 PË. E saktë.

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Për referencë, të nderuar
2 Gjykatës, bëhet fjalë për Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 35.
3 PY. Jakup Kastrati ka qenë personi që të ka thënë që Jakup
4 Krasniqi e kishte marrë në telefon Cen Deskun, Jakup
5 Kastratin, -- jo, që i kishte quajtur, domethënë Jakup
6 Krasniqi, Cen Deskun, Jakup Kastratin, Ramiz Hoxhën dhe Selman
7 Binishin kolaboracionistë. Nga ky person i ke dëgjuar apo jo,
8 po, Dëshmitar?

9 DËSHMITARI: Përsëritet përkthimi se e ka ngatërru.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Patjetër. Atëherë, Jakup
11 Kastrati të ka thënë ty se, Jakup Krasniqi i ka quajtur Cen
12 Deskun, Jakup Kastratin, Ramiz Hoxhën dhe Selman Binishin
13 kolaboracionistë. Këtë ta ka thënë Jakup Kastrati, është e
14 saktë Dëshmitar?

15 PË. Po, Jakupi kish thënë.

16 PY. Javën e shkuar --

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe për procesverbal e kam
18 fjalën për paragrafin 35 të Shënimit Përgatitor numër 2.

19 PY. Përpara një jave të janë treguar disa faqe të dëshmisë së
20 Jakup Krasniqit në Tribunalin e Hagës, a është e saktë kjo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Më kanë tregue dhe kjo e vërteton që s'e ka thënë Jakup
23 Krasniqi atë fjalë për Cen Deskun dhe Jakup Kastratin.

24 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] U shpreha keq. E kam fjalën
25 për paragrafin 8 të Shënimit Përgatitur, të nderuar Gjykatës.

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 122

1 PY. Pasi jua treguan këto faqe e keni informuar Prokurorin se
2 është e mundur që Jakup Kastrati ta ketë keqkuptuar dëshminë e
3 Jakup Krasniqit, a ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 PË. Kam thënë edhe ashtu besoj mbas atyne fakteve të
5 prezantuara.

6 PY. Ju e keni thënë këtë sepse Jakup Krasniqi nuk i është
7 drejtuar shprehimisht Jakup Kastratit si kolaboracionist në
8 faqet që ju treguan juve, a është e saktë kjo?

9 PË. E saktë edhe mbas ato që e kam pa e besoj dhe është e
10 vërtetë që ai s'i ka quajtur kolaboracionistë.

11 PY. A jeni në dijeni që z. Krasniqi ka dhënë gjithashtu
12 dëshmi në gjykimin kundër Fatmir Limajt sa i takon vrasjes së
13 Selman Binishit dhe Ramiz Hoxhës, jeni në dijeni të kësaj,
14 Dëshmitar?

15 PË. Jo, nuk jam se nuk e kam përcjellë gjykimin e Fatmir
16 Limajt.

17 PY. Me të drejtë.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do doja të vendosej në
19 ekran prova me numër P792. Shqipja është kjo; anglishtja
20 përfundon me -ET.

21 I nderuar Gjykatës, a do bëni një pushim tani apo të
22 vazhdoj.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem shkojmë tek faqja
25 që përfundon në numrin 68091, në të dyja versionet.

1 PY. Dëshmitar, lexoje nga fillimi deri tek përgjigja e tretë.
2 Për t'ju dhënë dhe kontekstin, është dëshmia e Jakup
3 Krasniqit, z. Jakup Krasniqi më 16 janar 2018. Lexoje, pra,
4 nga fillimi deri tek përgjigja e tretë.

5 Prokuroria ua tregoi ju këtë tekst javën e kaluar?

6 PË. Jo. Më tregoi një pjesë të procesverbalit në gjykimin e
7 Fatmir Limajt.

8 PY. Të ish-Tribunalit të Hagës?

9 PË. Po. Jo nga këto.

10 PY. Këtë. Në atë gjykim, i kanë bërë pyetje bërë pyetje Jakup
11 Krasniqit lidhur me arrestimin e Jakup Kastratit dhe Cen
12 Deskut dhe ju mund ta shihni vetë nga procesverbali që z.
13 Jakup Krasniqi e ka sqaruar dhe ka thënë:

14 "Arrestimi nuk ka qenë puna ime."

15 Duhet të përgjigjeni. Ka thënë dëshmitari:

16 "Nuk ishte çështje ime çështja e arrestimeve."

17 PË. Saktë. Besoj në atë që s'ka qenë çështje e tina dhe kurrë
18 s'ka thënë as Jakup Kastrati që ka ndiku Jakup Krasniqi që ta
19 arrestoj.

20 PY. Faleminderit. Më pas e kanë pyetur z. Krasniqi a ishin
21 arrestuar ata si kolaboracionistë, përgjigja e tij ka qenë
22 kjo:

23 "Unë nuk besoj që janë marrë si kolaboracionistë, pasi
24 unë Cen Deskun e kam njohur mirë personalisht. Në atë periudhë
25 ka qenë periudha e armëpushimit. Ata kanë qenë në LDK e kanë

1 pas politikë tjetër, e ndoshta kjo është konsideruar si
2 pengesë për UÇK-në, por nuk janë marrë si kolaboracionistë,
3 pasi ne nuk e kemi pasur këtë informacion”.

4 Kjo është zbardhur në procesverbal, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. A pajtoheni me mua, Dëshmitar, atëherë që jo vetëm që
7 Jakup Krasniqi nuk i ka akuzuar si kolaboracionistë Jakup
8 Kastratin dhe Cen Deskun, po në mënyrë kategorike e ka
9 përjashtuar si mundësi?

10 PË. Saktë. Për arsye se e kuptueshme a që Cen Deskin e ka
11 njoft në kohën kur kanë punuar ai si punëtor i arsimit në
12 shkollën fillore dhe Jakup Krasniqi si profesor.

13 PY. Flasim për Ramiz Hoxhën dhe Selman Binishin.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë, ju lutem, në faqen
15 që përfundon me numër 68090, në të dyja versionet. Shkojmë
16 poshtë në të dyja versionet.

17 PY. Shikoni paragrafin e parë, pra, pyetjen e parafundit ju
18 lutem në faqe. Këtu ku thotë Prokurorja:

19 “A keni dëgjuar për vrasjen e Selman Binishit dhe Ramiz
20 Hoxhës?”

21 E gjetët, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Lexoje për një çast me mendje.

24 PË. Po, e lexova.

25 PY. Kur i është bërë pyetje për vrasjen e Selman Binishit dhe

1 Ramiz Hoxhës, Jakup Krasniqi ka thënë që e ka dëgjuar këtë gjë
2 pas luftës, saktë?

3 PË. Saktë.

4 PY. Dhe ai thotë që:

5 "...dhe e kam thënë edhe atëherë dhe sot po e them çdo
6 vrasje e shqiptarëve na ka ardhur keq. Në luftë ne kemi
7 organizuar në kuadër të ushtrisë, të policisë e jo kundër
8 civilëve qofshin ata serbë dhe shqiptarë, pra, nuk jemi marrë
9 me njerëz të pafajshëm".

10 Kjo ka qenë dëshmia e tij. E shihni?

11 PË. Po.

12 PY. Pra, z. Krasniqi nuk ka thënë që Selman Binishi dhe Ramiz
13 Hoxha kanë qenë kolaboracionistë, apo jo, Dëshmitar? Ai nuk e
14 ka thënë këtë?

15 PË. Jo, siç shihet.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim një paragraf tjetër.
17 Shohim faqen që përfundon me 68093.

18 PY. Do lexoj nga mesi i paragrafit të dytë lart, Dëshmitar.
19 Lidhur me Ramiz Hoxhën dhe Selman Binishin, Jakup Krasniqi ka
20 thënë:

21 "Shtabi i Përgjithshëm nuk merr përgjegjësinë për këto
22 vrasje pasi sa jam unë në dijeni ato kanë ndodhur për arsye
23 personale. Dëshiroj t'i them disa fjalë edhe për familjet e
24 dëmtuara dhe Fatmir Limën. Jam i bindur se Fatmir Limaj nuk ka
25 pasur përgjegjësinë për këto vrasje, pasi sa jam unë në

1 dijeni, njërin e ka pasur bashkëfshatar ndërsa tjetri ka qenë
2 nga fshati fqinjë, afër në të cilin ai e ka edhe një dajë,
3 andaj as unë e as Fatmiri, as Shtabi i Përgjithshëm nuk jemi
4 marrë me fshatarë. Shtojmë se ata kanë pasur maska e unë nga
5 data 12 qershor 1998 kam dalë pa maskë, në fakt, kemi dalë
6 publikisht dhe askush nga UÇK-ja nga ai moment nuk ka pasur
7 përdorur maska e nëse janë përdorur maska është vepruar në
8 kundërshtim me UÇK-në.”

9 E gjetët këtë, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, përsëri z. Krasniqi nuk thotë që Selman Binishi dhe
12 Ramiz Hoxha kanë qenë kolaboracionistë, a kam të drejtë?

13 PË. Keni të drejtë. Saktë. E saktë.

14 PY. Tani të kalojmë tek një temë tjetër. Gjatë seancës
15 përgatitore me Prokurorinë javën e kaluar, Prokuroria ju
16 tregoi një komunikatë që ishte e datë 25 qershor 1998 për të
17 cilën ju komentuat se nuk ju kujtohej kjo komunikatë, po
18 përgjithësisht këto ishin informata që përmbanin këto
19 komunikata. Më pas ju thatë se:

20 “...kishte pasaktësi në komunikatat e UÇK-së.

21 Veçanërisht: Sa i takon sukseseve të UÇK-së përkundrejt
22 forcave serbe, pasi këto ekzagjeroheshin...”

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, lexojeni të gjithë
24 paragrafin për hir të dëshmitarit.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po kolegu mund ta trajtojë

1 vetë tek pyetjet plotësuese.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, lexojeni
3 ju të gjithë paragrafin.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Ka dhe një pjesë të dytë paragrafi ku thotë:

6 "...komunikatat ishin të paplota. Ato nuk raportnin
7 tërësisht sukseset që kishte pasur Gani Krasniqi dhe Isni
8 Kilaj në zonën e lirë të Malishevës."

9 Po mua më intereson pjesa e parë kur ju keni thënë ka
10 pasur pasaktësi dhe ekzagjerime në komunikata, kështu?

11 PË. Fakt. Ashtu mendoj unë.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran provën me
13 numër P295.

14 PY. Ndërkohë që presim materialin. Dëshmitar, ju jeni larguar
15 nga Kosova dhe UÇK-ja në shtator të 1998 dhe shkuat në
16 Slloveni, saktë?

17 PË. Saktë.

18 PY. Ju e dëshmuat, e patë me sytë tuaj, pra, ofensivën e
19 serbëve në Rahovec, Llapushnik dhe Malishevë në korrik të
20 1998, saktë?

21 PË. Saktë.

22 PY. Ju kur keni folur me Prokurorinë në 2019, e keni
23 përshkruar këtë periudhë si një periudhë kaosi të plotë,
24 kështu?

25 PË. Kështu ka qenë.

1 PY. A është e vërtetë, Dëshmitar, që UÇK-ja në të tria këto
2 vende ishte dëmtuar rëndë edhe infrastruktura ishte dëmtuar po
3 ashtu shumë?

4 PË. Saktë. Ma së miri ishte ai përshtkrimi i shtypit
5 ndërkombëtar apo hetuesve se në atë kohë thuaja nuk ekzistonte
6 grupacioni i UÇK-së.

7 PY. Do shohim një komunikatë tjetër në ekran. Është nga Zëri
8 i Kosovës, është data 8 tetor 1998 dhe mban datën komunikata
9 numër 7 - më falni - "Komunikata numër 57, po.
10 Shohim paragrafin e shtatë, ju lutem.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbase është nevoja të
12 zmadhojmë pak shqipen.

13 PY. Do t'ua lexoj çfarë thotë ky paragraf. Thotë:

14 "Gjatë kësaj ofensive, armiku gjatë gjithë ofensivës tre
15 mujore", pra, në korrik të 1998 -- edhe një herë "armiku gjatë
16 gjithë ofensivës tre mujore arriti t'i shkaktojë dhimbje të
17 mëdha shpirtërore dhe dëme të pallogaritshme popullit
18 shqiptar, por nuk arriti të dëmtojë seriozisht efektivin
19 luftarak të UÇK-së."

20 Mesa dini ju, Dëshmitar, në fakt, UÇK-ja u mund. Ju vetë
21 e konfirmuat, kështu?

22 PË. Saktë.

23 PY. Që do të thotë se nuk ishte e vërtetë kjo që është thënë
24 këtu që forcat serbe nuk arritën ta dëmtojnë seriozisht
25 efektivin luftarak të UÇK-së?

1 PË. Po, këto janë shkru këto komunikata diku nga kolltukët e
2 vendeve perëndimore dhe kanë mujt të shprehin çka dojnë, po
3 s'përkojnë me realitetin.

4 PY. Kjo ishte një nga ato rastet e ekzagjerimeve që thatë
5 edhe ju, që ekzagjeroheshin ndonjëherë?

6 PË. Ashtu mendoj.

7 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Faleminderit.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 znj. Alagendra.

11 Pyetje nga Prokuroria?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

13 Pyetje vijuese nga z. Halling:

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, kam vetëm disa pyetje sqaruese që janë bazuar
16 në pyetjet e Mbrojtësit të Viktimave dhe Ekipeve të Mbrojtjes.
17 Do të doja të shihnim disa prej deklaratave të mëparshme në
18 lidhje me këto.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran
20 prova që mban numrin P1694.2, faqja 29 në anglisht dhe faqja
21 32 nga fundi dhe faqja 33 në shqip.

22 PY. Ndërkohë që presim të shohim materialin në ekran, a ju
23 kujtohet që bëri pyetje Mbrojtja e Thaçit dhe e Veselit sa i
24 takon hierarkisë ditët e para të krijimit të UÇK-së,
25 vullnetarëve, disiplinës brenda UÇK-së. Ju kujtohet kjo linjë

1 pyetjesh?

2 PË. Po, si pyetje.

3 PY. Në këtë pjesë të deklaratës --

4 Z. HALLING: [Përkthim] Më duket se nuk përputhet
5 referenca. E bëjmë kështu, po e lexoj unë.

6 PY. Ju bëri pyetje Prokuroria:

7 "Ju keni thënë disa herë që meqë ishte ushtri vullnetare
8 UÇK-ja, s'mund të kishte pasoja kur nuk respektoheshin kodet e
9 etikës që diskutuam?"

10 Ju jeni përgjigjur:

11 "Unë e kisha fjalën sjelljen brenda për brenda me njëri-
12 tjetrin. Nuk po them që sjellje e gabuar ndaj civilëve. Ne
13 duhet t'i ndalonim e t'u hiqim armët."

14 Kështu?

15 PË. Po.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim pjesën 4. Duhet të ketë
17 numrin P1694.4, faqja 8 anglisht dhe faqja 9 shqip.

18 PY. Dëshmitar, Mbrojtja e Thaçit ju bëri disa pyetje lidhur
19 me urdhrin për zyrat e LDK-së. Dhe gjatë intervistës ti ke
20 thënë që kjo ka dalë në emër të Gani Krasniqit, urdhri ka dalë
21 në emër të Gani Krasniqit, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe keni thënë në këtë faqen këtu se -- kur ju kanë thënë

24 "Ju thatë diçka më përpara. Ju pyeta çfarë mund të
25 ndodhte në qoftë se do të refuzonit të zbatonit në urdhër nga

1 Gani Krasniqi dhe ju thatë që 'Mund të ishit larguar nga UÇK-
2 ja'?"

3 Dhe ju i jeni përgjigjur:

4 "Ma merrshin armën dhe isha largu nga UÇK-ja.

5 Vullnetarisht kam hyr dhe vullnetarisht kam dalë në fund."

6 Kështu?

7 PË. Saktë.

8 PY. Ju kanë bërë pyetje dhe për personat që merrnin hak dhe
9 sidomos sa i takon shpagimit ose hakmarrjet me familjet serbe
10 në Malishevë. Në Shënimin Përgatitor - në paragrafin 25 - ke
11 thënë se "ishe i shqetësuar se mos ushtarë të tjerë të UÇK-së
12 apo dhe civilë mund t'i lëndonin familjen serbe në Malishevë.
13 Sepse shumë prej këtyre personave kishin humbur familjarë dhe
14 mund të donin të merrnin hak".

15 Pra, shqetësimet e tua kishin lidhje me ushtarët e UÇK-së
16 dhe civilët se mos këta persona dëmtonin ose lëndonin civilët
17 në Malishevë?"

18 PË. Po, e kisha frikën në atë kohë.

19 PY. Këto gratë në atë familjen serbe, a të thanë ty që nuk e
20 dinin se ku ishin burrat e familjes?

21 PË. Ato së pari më thanë që nuk e dinë ku janë. Unë ju
22 tregova që janë në Malishevë në shtabin e njësisë Lumi, si
23 UÇK. Edhe dy ditë e para s'kanë folur për burrat e tyre.
24 Sigurisht e kishin frikën për fëmijën dhe për fatin e tyre.

25 PY. Javën e kaluar - në provën 1695, paragrafi 26 - ju thatë

1 që tri ditët e para u kujdesët për këto gratë dhe këto gratë
2 thanë që e dinin se i kishin ndarë prej burrave dhe nuk e
3 dinin se ku ishin burrat. Nuk kishit informacion se kush
4 ushtarë të UÇK-së i sollën këto gra në Malishevë apo sesi i
5 sollën këto gra në Malishevë. I qëndroni ende kësaj?

6 PË. Po.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Tani qëndrojmë tek kjo intervistë,
8 por shkojmë në faqen 11 tek anglisht dhe faqja 13 tek shqipja.

9 PY. Në këtë pjesë të intervistës ju kanë bërë pyetje për
10 kolaboracionistët dhe ju keni thënë:

11 "Se kishit dyshime për disa persona", kështu?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është në faqen 11, fillon në
13 rreshtin 18. Pak më poshtë tek anglishtja.

14 PY. Pra, ju keni thënë -- pyetja:

15 "Keni pas dyshime për persona, a është e saktë?"

16 Ju thatë - më falni - pyetja ka qenë:

17 "A keni pasur dyshime për persona, kështu?"

18 Dhe ju i jeni përgjigjur:

19 "Jo, jo nuk kemi pasur, sepse ne jemi persona të
20 respektuar në komunitetet ku jetojmë sepse ne sillemi mirë, ne
21 do kishim biseduar, do t'u thoshim të kujdeseshin."

22 Kështu?

23 PË. Korrekt.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen 12 tek anglishtja
25 dhe 13 tek shqipja.

1 PY. Është sqaruar më tej nga intervistuesi dhe të ka thënë.

2 "Dua t'i kuptoj më mirë. Kush akuzohej si kolaboracionist
3 dhe dua të kuptoj kush besoj se në të vërtetë ishin
4 kolaboracionistë. Kjo ishte luftë, kështu që ma merr mendja që
5 disa persona vërtetë ishin kolaboracionistë edhe disa persona
6 janë akuzuar gabimisht."

7 Dhe ju keni thënë kështu:

8 "Këta të parët, ai grupi i parë, ata që ishin vërtetë
9 kolaboracionistë, ata s'prisnin që të bëhej UÇK-ja publike.
10 Kishte shumë syresh. Dhe ka prej tyre disa që jetojnë ende në
11 Serbi. Po për këtë do kujdeset drejtësia - më falni - por ka
12 ndodhur padrejtësi."

13 Dhe pastaj pyetja ka qenë: Kur është bërë publike UÇK-ja
14 në zonën tuaj?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 DËSHMITARI: Jo, s'ka përkthim.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Një çast. Ta zgjidhim mund të ketë
18 një problem teknik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjoni?
20 Më dëgjoni? Okej.

21 DËSHMITARI: Në rregull.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe më
23 dëgjoni tani, Dëshmitar?

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Test 1, 2, 3.

1 DËSHMITARI: Po.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Korrigjova dhe pak
3 citimin. Citimi i parë ka qenë nga prova P1692.

4 PY. Në rregull. Kthehemi dhe një herë. Do ta bëj dhe një herë
5 pyetjen, Dëshmitar. Unë ju lexova një pjesë të intervistës. Ta
6 lexojmë edhe një herë?

7 PË. Jo, s'ka nevojë.

8 PY. Domethënë, keni folur për ata që vërtetë kanë qenë
9 kolaboracionistë keni thënë që ata s'prisnin që të dilte UÇK-
10 ja publikisht. Kur është bërë UÇK-ja publike në zonën tuaj,
11 është pyetja?

12 PË. Më 16 qershor 1998.

13 PY. Dhe që kjo që thoni ju për kolaboracionistët është ende e
14 saktë që nuk prisnin ata që të bëhej publike UÇK-ja, qëndron
15 ende?

16 PË. Po, është mendimi i jemi ky kështu. Dhe ashtu besoj që
17 është.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim në ekran provën P795

19 PY. Për këtë ju bëri disa pyetje Mbrojtja e Jakup Krasniqit
20 lidhur me dëshminë e z. Jakup Krasniqi dhe ju në dëshminë me
21 ZPS-në keni treguar se çfarë të ka thënë Jakup Kastrati lidhur
22 me ato që kishe thënë Jakup Krasniqi në Hagë. Kjo është një
23 pjesë e transkriptit që e lexuam bashkë gjatë seancës
24 përgatitore javën e kaluar.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem që të shkojmë në faqen

1 3397 të transkriptit. Kjo është një anglisht, unë po lexoj
2 vetëm fragmentet përkatëse. Edhe një herë 3397.

3 PY. Në krye të faqes ju është bërë një pyetje nga Prokurori,
4 në fakt, më falni, z. Krasniqi i ka bërë pyetje Prokurori:

5 "A ke dëgjuar gjë asokohe për arrestimin e Jakup
6 Kastratit dhe Cen Deskut?"

7 Dhe z. Krasniqi i është përgjigjur:

8 "Është përmendur lufta speciale këtu. Është e vërtetë që
9 asokohe që kishte disa persona që kryenin luftë speciale dhe
10 ata persona jo vetëm që ishin të armatosur, ishin kyçur në
11 ushtri, por ama kishte dhe civilë sepse edhe në UÇK kishte
12 ish-oficerë të Armatës Jugosllave që kishin qenë dikur pjesë e
13 Shërbimit Sekret të Armatës Jugosllave. Kishte persona që
14 ishin ndëshkuar ose akuzuar penalisht për vepra penale. Dhe do
15 të thoja që pas ofensivës së verës këta persona i kanë dhënë
16 armikut 5000 a 6000 armë."

17 Dhe më poshtë në të njëjtën faqe thotë:

18 "Ka pas dhe persona që të kërkoheshin të dorëzoheshin
19 armët në Malishevë. Dhe këtë e ka bërë Januz Kastrati dhe Cen
20 Desku. Në fillim dyshohej që në këta kishin bërë thirrje
21 fillimisht, u kishin bërë thirrje fillimisht disa ushtarëve që
22 të dorëzonin armët."

23 Kjo pjesë e dëshmisë së Jakup Krasniqit a ishte diçka që
24 e lexuam bashkë gjatë seancës përgatitore javën e kaluar?

25 PË. Po.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër. Është
2 faqja 3398. Më poshtë.

3 PY. Këtu Jakup Krasniqi, në fakt, po e lexoj pyetje-
4 përgjigjen. I kanë bërë këtë pyetje Jakup Krasniqit:

5 "Artikulli i referohet edhe ekzekutimit të Selman
6 Binishit nga Baja dhe Ramiz Hoxhës nga Bellanica. Keni dëgjuar
7 diçka lidhur me këto asokohe? A ju informuan ju në cilësinë
8 tuaj si zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të
9 Përgjithshëm?"

10 Dhe Jakup Krasniqi është përgjigjur kështu:

11 "Mendoj se fjala 'ekzekutim' është përdorur në një kuptim
12 tjetër. Ata duhet të jenë vrarë, sipas informacionit që kam
13 unë, por në fakt ata i jepnin informata forcës -- forcave
14 serbe në Malishevë."

15 A është dhe kjo po ashtu një pjesë që ta lexuam javën e
16 kaluar në seancën përgatitore?

17 PË. Po.

18 PY. Në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 7, thuhet:

19 "Sa i takon dëshmisë së Jakup Krasniqit për Ramiz Hoxhën
20 dhe Selman Binishin, kjo përputhet me atë që teka thënë Jakup
21 Kastrati. Pra, atë që ka thënë Jakup Krasniqi për Hoxhën dhe
22 Binishin - sipas jush - nuk është e vërtetë."

23 Kështu?

24 PË. Saktë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

2 Barthe ka disa pyetje.

3 Pyetje nga Trupi Gjykses:

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

5 PË. Mirëdita.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më dëgjoni mirë?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një a dy pyetje lidhur
9 me z. Fetah Rudi, i cili sipas dëshmisë suaj ka qenë dhe
10 anëtar i UÇK-së dhe i LDK-së gjatë luftës edhe mik i juaj.

11 Sot ju thatë se një arsye tjetër pse u arrestua dhe u
12 burgos z. Rudi nga UÇK-ja ka pas lidhje me një mosmarrëveshje
13 për shpërndarjen e ndihmave humanitare. Këtë ia keni thënë
14 Mbrojtjes së Thaçit sot në faqen 80 të transkriptit.

15 Fillimisht, a të kujtohet që e the këtë sot?

16 PË. Së pari, u përgjigja me po, se këtë e tha Mbrojtja e z.
17 Thaçi. Thashë kam njohuri pej palëve tjera, se nuk e thashë
18 unë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, kështu ishte. Në fakt ju
20 thatë që thuhej se kishte mosmarrëveshje për shpërndarjen e
21 ndihmave humanitare.

22 Tani unë do të doja të dija prej jush fillimisht kush ta
23 ka thënë që mund të ketë qenë një prej arsyeve kjo për
24 ndalimin e z. Rudi? Kush ua ka thënë ju këtë?

25 PË. Është përdorë prej njerëzve tjerë të cilët s'kam emër për

1 ta thënë. A unë u bazova vetëm në deklaratat, domethënë, që ma
2 ka thënë z. Rudi për pjesën ai që thotë. Këtë e kam të
3 dëgjuar, po jo për dikë me emër të veçantë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë lidhur
5 me këtë. Z. Rudi nuk ta ka thënë ty këtë që ka pas, që ai
6 është arrestuar si rezultat i mosmarrëveshjes që ka pasur për
7 shpërndarjen e ndihmave humanitare, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Jo, s'ma ka thënë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
10 tjera.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
13 Smith.

14 Dhe mirëdita, Dëshmitar. Edhe unë kam pak pyetje për ju.
15 Pyetjet e para kanë të bëjnë me Haxhi Shalën. Së pari, a jeni
16 në dijeni apo a mund të konfirmoni që ai është i afërm i
17 Fatmir Limës?

18 PË. Është i të njëjtit fshat.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e përsëris edhe një
20 herë. A e dini që ata janë nip e dajë, jeni në gjendje që ta
21 konfirmoni këtë, Dëshmitar?

22 PË. Jo, s'kam informacion të tillë unë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kthehem përsëri pyetjes
24 sime të parë, a jeni i informuar apo jeni në dijeni që ata
25 janë të afërm, Dëshmitar?

1 PË. Flitet, po nuk jam i saktë 100 për qind se s'kam ndonjë
2 kontakt të afërt me ta.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kanë pyetur disa herë
4 lidhur me pyetjen, me takimin që ka ndodhur në qershor apo
5 korrik në vitin 1998 midis njësimit Çeliku dhe Lumi ku janë
6 zgjidhur tensionet që kanë ekzistuar ndërmjet këtyre dy
7 njësive. A ju kujtohen pyetjet që ju janë bërë lidhur me këtë
8 temë, dëshmitar?

9 PË. Besoj që po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është
11 kjo: Ky takim a ka qenë i suksesshëm për zgjidhjen e
12 tenseve që ekzistonin midis dy njësiveve?

13 PË. Besoj që, po, ka ndiku pozitivisht.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pas atij takimi pjesëtarët
15 e dy njësiveve a kanë bashkëpunuar më shumë, mesa dini ju?

16 PË. Po, mendoj që kemi qenë më të respektueshëm dhe nga ana
17 atyne, posaçërisht ne si policë ushtarakë që ishim në
18 Malishevë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka pasur më probleme të
20 tjera ndërmjet dy njësiveve pas këtij takimi për të cilat të
21 paktën ju jeni në dijeni?

22 PË. Jo, nuk jam në dijeni.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbrojtja e z. Krasniqi dhe
24 tani para pak çastesh Prokurori ju bënë pyetje lidhur me Jakup
25 Kastratin, kam edhe unë disa pyetje tjera pasuese.

1 Në seancën përgatitore numër 2, në shënimin përkatës të
2 asaj seance në numrin 2, përpara një jave në faqen 2, juve
3 thuhet që keni thënë si më poshtë në paragrafin 8:

4 "Një person mund të konsiderohet si tradhtar për
5 inkurajimin e UÇK-së që të dorëzojë armët e tyre serbëve."

6 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po edhe këtu jam përgjigj në pyetje dhe kam dhënë
9 mendimin tem çka, si e konsideroni ju ka qenë pyetja.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju shtuat, sipas fjalëve
11 tuaja, që "është tërësisht e pavërtetë që Cen Desku dhe Jakup
12 Kastrati kanë bërë ndonjë gjë të tillë të kësaj natyre". A ia
13 keni thënë këtë gjë ZPS-së dhe a i qëndroni këtij qëndrimi,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, i kam thënë dhe qëndroj.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dy grupe tjera
17 pyetjesh për ju dhe dua të jem i sigurtë në qoftë se e kuptoj
18 siç duhet dëshminë tuaj. Tema e parë ka të bëjë me mbylljen e
19 zyrës së LDK-së në Malishevë. A ju kujtohen pyetjet e bëra
20 lidhur me këtë temë, Dëshmitar?

21 PË. Po, më kujtohen.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kuptoj drejt dëshminë
23 tuaj që mënyra se si e keni kuptuar ju situatën ishte që UÇK-
24 ja i ka kërkuar LDK-së që të largohet nga zyra që kishin sepse
25 UÇK-së i nevojitej hapësira ku ishte LDK-ja? A e kam kuptuar

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 141

1 drejt këtë, Dëshmitar?

2 PË. Po, ashtu ka qenë dhe ashtu qëndron.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur LDK-ja u largua nga
4 ato zyra, UÇK-ja i mori ato ambiente, u vendos në ato zyra,
5 Dëshmitar, mesa dini ju?

6 PË. Nuk arritëm të vendosemi, po fillum t'i meremetojmë diçka
7 se ishin pa rregullim të brendshëm, përjashtim një zyrës.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra përgjigja për pyetjen
9 time është, jo, që UÇK-ja nuk u vendosë në ato zyra, a është e
10 saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Saktë. Përjashtim të policisë ushtarake, ne tre kemi
12 fillu me bë zyrën aty.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur keni filluar ju t'i
14 përdorni ato si zyra, në qoftë se ju kujtohet data pak a
15 shumë?

16 PË. Po besoj ka data 25 qershorit 30, pesë ditë 6 s'kena
17 vepru më shumë aty.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj u larguat përsëri
19 nga aty, kështu?

20 PË. Jo, se u largum. Zyra mbeti, po për shkak të punimeve që
21 ndodhshin, s'mujshim të futeshim brenda.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju bëj dhe një pyetje
23 ju dhe/ose anëtarë të tjerë të policisë ushtarake të UÇK-së a
24 u kthyet më në atë zyrë pasi u bënë rinovimet, pasi u bënë
25 punimet?

1 PË. S'përfundun ato. Se ishte lufta në Rahovec dhe Malisheva
2 ra në duart të forcave serbe.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk u shku më
4 mbrapsht aty në atë zyrë, kështu?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të jem i sigurtë që e
7 kam kuptuar siç duhet dëshminë tuaj lidhur me autoritetin dhe
8 rregullat e policisë ushtarake të cilës ju i përkisni. A e
9 kuptoj drejt, Dëshmitar, që dëshmia juaj është që roli juaj si
10 polic ushtarak ishte tërësisht i një natyre këshillimore, e
11 kuptoj drejt këtë?

12 PË. Saktë. Ashtu ka qenë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rast se ju dhe kolegët
14 tuaj, Jakup Hoti dhe kolegu tjetër i policisë ushtarake, në
15 qoftë se ju do shikonit një anëtar të UÇK-së që dhunonte ose
16 keqtrajtonte një civil, çfarë do bënit ju? Çfarë hapi do
17 merrnit për ta trajtuar diçka të tillë, në qoftë se do
18 gjendeshit në një situatë të ngjashme?

19 PË. Po sigurisht që do ta këshillonim që të mos përsëritet
20 një gjë e tillë dhe të mos përdoret dhuna ndaj asaj.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se këshilla juaj
22 nuk merrej parasysh dhe në qoftë se ushtari i UÇK-së, ushtari
23 përkatës do vazhdonte që ta keqtrajtonte civilin X, nuk mund
24 të bënit dot asgjë tjetër ju përveçse ta këshillonit këtë
25 persona, këtë po thoni?

1 PË. Po, përveç kësaj do t'i kontaktonim familjen e tij,
2 prindërit e tij dhe do të kërkonim që të dhanë kontributin e
3 tyre për mos me ndodhë një gjë e tillë. Po s'kemi pas raste të
4 tilla.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në qoftë se e kuptoj
6 siç duhet, dëshmia juaj është që ju nuk keni pas kompetencë që
7 të arrestoni persona të tillë. A e kam kuptuar siç duhet
8 dëshminë tuaj, Dëshmitar?

9 PË. Po, drejt.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH [Mikrofoni çaktivizuar].

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
13 Smith.

14 Dëshmitar, dëshiroj që të filloj me një pyetje.

15 Po për këtë do të doja t'i kërkoja Sekretares së pari që
16 të paraqesë në ekran dokumentin 1D00006, që është urdhri që
17 është diskutuar tani së fundmi, pra, urdhri që ka të bëjë me
18 ambientet e zyrës.

19 Kur të paraqitet ky dokument në ekran që keni përpara, do
20 shihni që në të thuhet -- e shihni dokumentin në paragrafin e
21 parë, Dëshmitar, ku thuhet se --

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] "Të gjitha lokalet e partive
24 politike, shoqatave dhe lokalet e tjera që gjenden në katin e
25 epërm 3, duhet të lirohen."

1 Përveç LDK-së, cilat parti tjera politike kishin zyra në
2 katin e tretë, Dëshmitar?

3 PË. Parti politike tjera nuk kishin fushëveprim në Malishevë
4 në atë kohë, po në katin e tretë ishin zyrat e Këshillit për
5 Mbrojtjen dhe Liri të Drejtave të Njeriut. Ishin zyrat e
6 shoqatës Nënë Tereza. Dhe me këtë kanë nënkuptu të gjithë tuj
7 përfshi edhe këto shoqatat.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fund të ditës juve ju
9 nevojitet hapësirë zyre për ju të tre. A kishte zyra të tjera
10 në kate të tjera të ndërtesës që mund të kishit përdorur ju,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po, po, kish edhe zyra tjera që u duhke tu
13 rregulloheshin.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka pas objekte të tjera
15 aty në afërsi që UÇK-ja mund t'i përdorte si hapësirë për
16 zyra?

17 PË. Jo, se i vetmi objekt shoqëror ishte ky. Dhe zyrat e
18 njësimit Lumi ishin në objekt privat.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pse ishte me rëndësi ose
20 pse ishte relevant që ju duhet që të punonit në një godinë që
21 ishte në aspektin, domethënë, që zotërohej në aspektin social?

22 PË. Për arsye se objekti privat kishte dhe një biznes aty
23 afër që ju duhke lokali atij.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në faqen 12 të provës
25 P1694.2, ju keni thënë që kishte një zyrë të madhe në faqen e

1 tretë, aty ku ishte LDK-ja, po ne na nevojiteshin zyra më të
2 vogla. Duket nga ajo çfarë thoni juve që ky vendim etiketonte
3 posaçërisht zyrat e LDK-së, a pajtoheni me këtë, Dëshmitar?
4 PË. Jo, s'ka pas të bëj vetëm me të LDK-së. Thashë edhe dy
5 shoqata tjera aty që u duhshin aty t'i lirojshin zyrat.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shikoni dhe një fjali tjetër
7 që është në paragrafin 2 dhe thuhet:

8 "Çelësat duhet që të dorëzohen brenda një dite sepse në
9 të kundërtën zyra do të shkatërrohet..."

10 Do ndaloj këtu për një moment. Ju keni thënë që gjuha që
11 është përdorur në vendim "nuk është pak e tepruar. Por është
12 shumë e tepruar", këtë keni thënë ju, në qoftë se qëllimi
13 ishte që thjesht të përdorej ambienti i zyrës. A ju kujtohet
14 t'ia keni thënë këtë ZPS-së, Dëshmitar?

15 PË. Po, e kam thënë.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në qoftë se synimi thjesht
17 ishte që të kishte qasje në ambiente zyre për tre policë
18 ushtarakë, duket e jashtëzakonshme që të kërcënohen zyrat me
19 shkatërrim në qoftë se ata nuk do të liroheshin brenda një
20 dite.

21 PË. Për atë kam thënë që është edhe e ekzagjeruar shkrimi
22 aty.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sot ju është bërë më parë
24 pyetja dhe kjo është pasqyruar në faqen 85 deri në 86 dhe në
25 përgjigje u keni thënë që:

1 "E thashë se mënyra si e keni kuptuar ishte kryesisht që
2 bëhej fjalë për hapësirë zyresh që i nevojitej UÇK-së. A ju
3 kujtohej kjo?"

4 Dhe përgjigja që ju jepni është:

5 "Po."

6 A vazhdoni që të besoni edhe tani që ky vendim nuk kishte
7 të bënte fare me shenjëstrimin e zyrave të LDK-së në atë
8 godinë, në atë objekt, Dëshmitar?

9 PË. Saktë. Kam besuar atëherë dhe sot besoj se s'ka qenë
10 fokusi ky.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjithashtu keni thënë në
12 intervistën me ZPS-në që LDK-ja vazhdoi me veprimtarinë e vet
13 në një godinë private, në një objekt privat, a është e saktë
14 kjo?

15 PË. Po, saktë është. Ashtu ka qenë.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ku është ky objekti privat?

17 PË. 30 metra prej këtij objektit, ku pronari i atij ishte dhe
18 anëtar i kryesisë së LDK-së.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të bëj dhe një sqarim të
20 fundit lidhur me atë çfarë ju thoni godinë sociale ose të
21 zotëruar në aspektin social. Derisa UÇK-ja e ka nxjerrë LDK-në
22 nga këto zyra, organet e komunës nuk kanë pas asnjë lloj
23 problemi që LDK-ja të kishte zyrat aty në atë godinë, a është
24 e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. S'ka funksionuar atëherë Malisheva si komunë. Komuna në

1 atë kohë kishte shku në Rahovec. Ishim të shpërndarë në
2 fshatrat e Malishevës në tri komuna - Klinë, në Suharekë,
3 Rahovec - dhe s'kishte autoritet komunal në atë kohë.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush ka pas kontroll mbi
5 qasjen në këtë objekt?

6 PË. Po në fillimet e para ka qenë LDK-ja si autoritet edhe
7 shoqatat. Dhe ne ia kemi kërkuar këtë për arsye se ai ish në
8 pronë, në pronësi të shoqërisë, të komunës.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por komuna e kishte toleruar
10 ose e kishte lejuar praninë e LDK-së në objekt, apo jo, është
11 e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje për ju,
14 Dëshmitar, të tjera.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
16 të tjera pasuese pas pyetjeve të Gjykatësve?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, kemi.

20 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

21 Tavakoli:

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

23 PY. Dëshiroj të flasim pak për objektin. Nuk është e saktë,
24 së pari, pyetja e Gjykatësit Gaynor që hapësira e zyrës
25 synohet që të përdoret vetëm nga tre policë të policisë

- 1 ushtarake, po jo, Dëshmitar? Se synimi i kësaj zyre ishte që
2 të përdorej gjithashtu edhe nga drejtoria civile publike e
3 Malishevës që ishte organizata për të cilën ishte caktuar Gani
4 Krasniqi si drejtues --
- 5 PË. Saktë, po unë për atë -
- 6 PY. -- a është e saktë kjo?
- 7 PË. -- fillun ndarjet atyne.
- 8 PY. Gani Krasniqi u largua, iku për në Shqipëri rreth datës
9 11 korrik, apo jo?
- 10 PË. Ashtu.
- 11 PY. Thatë që pasi UÇK-ja mori kontroll, gjithsesi, domethënë,
12 kjo letër mban datën e 10 korrikut, e saktë, Dëshmitar?
- 13 PË. Saktë.
- 14 PY. Ju thatë dhe kjo, në fakt, ka të bëjë me pyetjet që ju
15 bëri Gjykatësi Mettraux, ju thatë ishte në përgjigje të
16 pyetjes që ju bëri Gjykatësi Mettraux që ju asnjëherë nuk i
17 morët ato zyra, në kuptim që nuk punuat në ato zyra. Pra, pasi
18 u liruan ambientet filluan punimet aty, apo jo, është e saktë
19 kjo, Dëshmitar?
- 20 PË. Po. U bënë ndarje se ishte një sallë e madhe.
- 21 PY. A pajtoheni me mua që arsyeja që pse UÇK-ja asnjëherë nuk
22 u vendos në ato lokale ishte për shkak të ofensivës serbe?
- 23 PË. Po, saktë.
- 24 PY. Ishte luftimi në Rahovec më 17 korrik dhe rreth tetë deri
25 në dhjetë ditë më pas ishte ofensiva serbe --

Dëshmitari: Ahmet Rrahmanaj (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 149

1 PË. Serbe e cila erdhi në Malishevë.

2 PY. -- ndodhi kjo ofensivë, apo jo?

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Mund ta përsërisësh dhe një herë pjesën e parë të
5 përgjigjes tuaj?

6 PË. Po. Ishte e saktë thashë se në atë periudhë mbas shtatë
7 dite tetë forcat serbe hyjtën në Malishevë dhe nuk u
8 shfrytëzua ajo asnjëherë nga ne.

9 PY. Pra, ju i qëndroni dëshmisë tuaj se qëllimi ishte që të
10 vendoseshit në ato ambiente dhe për ato arsye u liruan zyrat,
11 a është e saktë kjo?

12 PË. Saktë.

13 PY. Dhe për shkak të faktit që bëhej fjalë për luftë dhe
14 situata ishte në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të faktit
15 që kishit, pësuar një sulm, kishte dhe një luftim, për këtë
16 arsye juve nuk mundët që të vendoseshit aty, a është e saktë
17 kjo?

18 PË. E saktë.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

20 Faleminderit.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Dëshmitar, kemi përfunduar me dëshminë tuaj. Ju thatë që

1 dëshironit të bënit disa komente. Mund t'ju japim dy minuta
2 për të bërë komentet tuaja. Ju lutem mos u drejtoni të
3 akuzuarve. Mos filloni të jepni dëshmi të re për gjërat të
4 cilat i keni thënë.

5 Ju thatë që keni një pyetje që ka të bëjë me procedurën
6 dhe keni një ankesë. Kështu që e keni fjalën për t'u shprehur
7 lidhur me këtë, Dëshmitar.

8 DËSHMITARI: Faleminderit, Kryetar i Trupit Gjykues.

9 Së pari, përshëndetje për ju. Po megjithatë përshëndetje
10 edhe për të akuzuarit se vijnë nga vendi im dhe kanë lë
11 pozicione udhëheqëse në vendin tonë.

12 Po pyetja s'ka pas të bëjë me këtë, po ju ma përkujtuat
13 që dua t'i përshëndes. Unë kam një shqetësim për rrugëtimin
14 tim dhe të njerëzve si unë që vijnë me dëshmu në këtë Gjykatë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
16 seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi në seancë publike.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shkurtimisht
10 përpara se të largohemi. Seanca nesër është pasdite dhe
11 thjesht dua t'ju them që klienti im dëshiron që të qëndrojë në
12 njësinë e paraburgimit përderisa bëhet fjalë për një çështje,
13 për çështje ligjore që do të diskutojmë. Thjesht dua t'ju
14 informojë që do bëjmë kërkesën përkatëse dhe do të donim që
15 klienti të qëndrojë në paraburgim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
17 absolutisht e pranueshme, megjithatë kini parasysh që duhet që
18 të bëni parashtrimet përkatëse, të bëni kërkesën për të mos
19 qenë i pranishëm në sallë.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është çështje organizative. Ka
21 ndodhur që unë të flas -- jemi mbivendosur, domethënë, kam
22 folur në të njëjtën kohë me përkthyesin. Nuk e di në qoftë se
23 duhet shkruar për të bërë një sqarim përkatës, po bëhet fjalë
24 në 88.1.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Flisni me

1 Zyrën Administrative.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do flas gjithashtu edhe me
3 kolegët për të parë në qoftë se do të duhet të bëj sqarimet
4 përkatëse.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Atëherë do takohemi përsëri nesër në orën 2.30 për
7 konferencën për ecurinë e çështjes. Kaq për sot.

8 E mbyllim këtu. Faleminderit.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.27

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25